



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 36/2020 (JR)
Datë 11.09.2020

Vendim nr. 20 (JR)
Datë 14.06.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 14.06.2022, ditën e martë, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, me:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike Irena Nino, e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, dhe përfaqësuesen ligjore të saj Romina Zano, të cilat kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, sot Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe kreu një hetim të plotë administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, duke konkluduar si më poshtë.

2.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

2.1.1. [...] Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “vetting”, pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

2.1.2. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit [...].

2.1.3. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaratim dhe balanca negative e fondeve në vitin 2014 prej 146.111 lekësh, nuk është e mjaftueshme që të passjellë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2.1.4. [...] Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se, në asnjë rast, pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

2.1.5. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër, nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut te drejtësia.

2.1.6. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ka arritur një nivel të besueshëm.

2.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, [...] subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

2.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

2.3.1. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGj-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

2.3.2. [...] subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

2.3.3. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

3. Komisioni, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kontrollin e figurës dhe ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 241, datë 26.02.2020, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka”.

II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit, ka ushtruar ankim¹ në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), Komisioneri Publik Darjel Sina, i cili ndan gjykim të kundërt me Komisionin dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmim në detyrë, duke kërkuar zbatimin e nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, për ndryshimin e vendimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Irena Gjoka.
5. Në vlerësim të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratime të pasakta dhe të pamjaftueshme ndër vite, si dhe rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare. Komisioneri Publik, në referencë të nenit 4, pika 2, nenit 59 pika 1, si dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, çmon se është i nevojshëm gjykimi i rrethanave ligjore dhe fakteve, me qëllim arritjen e një vendimmarrjeje në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.
6. Komisioneri Publik në ankim ka parashtruar shkaqe ankimore lidhur me kriterin e pasurisë, si më poshtë.

6.1. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 71 m², të ndodhur në rr. {***} Tiranë:

i. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, sa i përket “tërheqjes së depozitës nga Banka e kursimeve, në shumën 93.000 lekë”, Komisioneri Publik pretendon se Raiffeisen Bank ShA nuk konfirmon këtë llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit.

ii. Për tërheqje depozite nga Tirana Bank, në shumën 800.000 lekë, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë 2004, nuk rezulton të ketë deklaruar shtesat në depozitën pranë Tirana Bank ShA dhe destinacionin e shumës së tërhequr nga kjo bankë, në dhjetor 2004, prej 1.254.484 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003², kursimet e poseduara në *cash* në vitin 2004 dhe, si rrjedhojë, nuk justifikohet me

¹ Shih: <http://ikp.al/2020/06/12/ankim-kunder-vendimit-nr-241-date-26-2-2020-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-znj-irena-gjoka/>.

² Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

të ardhura të ligjshme shuma prej 1.700.000 lekësh, e deklaruar si pagesë për blerjen e këtij apartamenti. Për këtë pretendim, Komisioneri Publik i referohet jurisprudencës së Kolegjit në vendimet³ e Juridiksionit të Rivlerësimit.

iii. Për *shumën 15.000 euro kursime të vitit 2005*, ka mospërputhje të deklaramëve në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, ballafaquar me deklaramet para ILDKPKI-së dhe ato gjatë hetimit administrativ. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk është deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimi i apartamentit me sipërfaqe 71 m², pasi nuk është deklaruar shuma prej 15.000 eurosh, si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie. Në analizë të burimit të deklaruar, rezulton se të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit për periudhën janar 2005 deri më 6 tetor 2005, janë rreth 685.000 lekë dhe nuk mbulojnë kursimin e deklaruar në shumën 15.000 euro.

iv. Për *depozitën në bankën Intesa San Paolo, në shumën 23.000 USD*, subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime kontradiktore gjatë hetimit administrativ krahasuar me deklaramet në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, për pjesën kontribuuese të saj në krijimin e kësaj shume. Analiza financiare e Komisionit për të provuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj depozite, duhej të ishte shtrirë deri në veprimin e parë bankar, atë të depozitimit të shumës, më datë 05.04.2002.

v. Në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare, rezulton se deri në prill 2002, kur është krijuar depozita 23.000 USD, *të ardhurat e ligjshme familjare* janë në total 3.974.289 lekë, ndërkohë që, përveç kursimeve në sistemin bankar të subjektit të rivlerësimit në vlerën 4.343.097 lekë, nga aktet në dosje provohet edhe blerja e apartamentit në Fier nga vëllai i subjektit A. M., më 18.01.2000, për vlerën 1.800.000 lekë, vlerë e cila nuk është përfshirë në zërin shpenzime në analizën e Komisionit. Vetëm investimet në pasuri të paluajtshme dhe kursimet e depozituara në sistemin bankar deri në prill 2002 (pa llogaritur shpenzime minimale jetese për një familje me 4 persona për periudhën 1993 – 2002) arrijnë shumën 6.143.097 lekë, konsideruar ndjeshëm më e lartë sesa të ardhurat e dokumentuara.

vi. Ndryshe nga Komisioni, Komisioneri Publik vlerëson se të ardhurat e përfituara nga shfrytëzimi i ullinjve nga babai i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 - 2005 mbështeten në akt ekspertimi privat dhe në deklarata të thjeshta të disa shtetasve, pa datë, dhe nuk bazohen në dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Komisioneri Publik kërkon një qëndrim të qartë dhe ligjor të Kolegjit pasi marrja parasyshe e këtyre akteve/deklaratave do të ndryshonte zërat në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

vii. Mbi *huan në shumën 2.000.000 lekë, marrë nga I. M.:* (a) Komisioneri Publik pretendon se të ardhurat e ligjshme nga emigracioni, në shumën 29.613 euro, janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në shtetin grek për një familje me 3 anëtarë, për periudhën deri në vitin 2005 [mbështetur në referencat e vendimit (JR) nr. 32/2019 të Kolegjit]; (b) ndryshe nga Komisioni, me konsideratë jurisprudencën⁴ e Kolegjit, Komisioneri Publik konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat nga shfrytëzimi i ullinjve, nuk konsiderohet dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

³ Shih vendimet (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39; nr. 11/2019, paragrafi 27.12.18; nr. 19/2019, paragrafi 84; nr. 20/2019, paragrafët 55 e 56; nr. 29/2019, paragrafi 31.

⁴ Shih vendimet (JR) nr. 12/2018 dhe nr. 32/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

6.2. Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 62,65 m²”, e ndodhur në Patos, Fier, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën e pasurisë *vetting* këtë pasuri në bashkëpronësi të subjektit me të afërmit e tij, bazuar në kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë.

6.3. Për pasurinë “dy garazhe me sipërfaqe 14 m² secili”, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, kthimin e huas 1.000.000 lekë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011 dhe posedimin e *cash*-it në këtë vit dhe, si rrjedhojë, nuk justifikohet me të ardhura nga burime të ligjshme shuma e depozituar pranë Raiffeisen Bank ShA, në datën 26.11.2013, përdorur për blerjen e dy garazheve. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj.

6.4. Për pasurinë automjet “Mercedes Benz”, modeli “B 180”:

i. Analiza financiare për të vlerësuar mjaftueshmërinë e të ardhurave nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit për të mbuluar blerjen e pasurisë dhe shpenzimet, duhej të shtrihej deri në datën 28.06.2014, që përkon me datën e pagesës së zhdoganimit të automjetit.

ii. Përfundimi i Komisionit se babai i subjektit ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 5.000 euro, nuk është i bazuar në gjendjen faktike të provave. Komisioni ka përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, edhe shumën prej 5.841.438 lekësh, në zërin të ardhura nga ulla, për periudhën 2006 – 28.06.2014, të cilat, si arsyetuar më sipër, nuk rezultojnë në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Huaja, sipas Komisionerit Publik, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë.

iii. Në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për huan e deklaruar dhe, rrjedhimisht, rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

6.5. Lidhur me “çështjet e tjera” në ankim, Komisioneri Publik ngre këto pretendime:

i. Mbi *transaksionin 12.000 euro* në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në bankën Societe Generale Albania ShA, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, që konsiderohen si provë gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të të kenë deklaruar kursime në *cash* në vitet 2005 dhe 2006.

ii. Mbi *transaksionin 10.000 euro* në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. S. Gj., në Tirana Bank ShA, Komisioneri Publik në ankim vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbeten thjesht në nivel deklarativ.

iii. Lidhur me huat e dhëna nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitet 2008 dhe 2012, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar mënyrat e marrjes së shumave nga bashkëshorti S. Gj. të huadhënësit H. M. dhe K. M. dhe as kthimin e tyre, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të këtyre marrëdhënieve, përkundër detyrimit që ligji i njej. Deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, datojnë pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, të administruara gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, nuk mund të konfirmojnë të vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to, kanë ndodhur realisht.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

7. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit nr. 241, datë 26.02.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
8. Në kuadër të veprimeve përgatitore të çështjes, janë ftuar palët në këtë proces, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka dhe Komisioneri Publik, që të depozitojnë në Kolegj parashtrimet e tyre së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime dhe akte t'u komunikohen reciprokisht palëve në proces dhe për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, për efekt të një ekonomie gjyqësore në kuadër të menaxhimit sa më efikas të procesit gjyqësor.
9. Në gjykimin e këtij ankimi në Kolegj, Institucioni i Komisionerit Publik u përfaqësua nga Komisionerja Publike Irena Nino. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në seancën gjyqësore publike të datës 26.05.2022, subjekti i rivlerësimit kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor të çështjes dhe pranimin në cilësinë e provës të akteve të reja që subjekti i rivlerësimit paraqiti në mbështetje të parashtrimeve të datës 29.04.2022. Trupi gjykues i Kolegjit, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të marrë në cilësinë e provës aktet shkresore⁵,

⁵(i) Deklaratë noteriale nr. {***} regj., datë 10.02.1998, nënshkruar nga babai i subjektit dhe shtetasi R. M. për tjetërsimin e tokës arë me sipërfaqe 1000 m², në vlerën 1.300.000 lekë; (ii) raport vlerësimi për llogaritjen e të ardhurave nga përdorimi i tokave bujqësore, për llogari të z. H. M., përgatitur nga eksperte L. B.; (iii) raport vlerësimi për llogaritjen e të ardhurave nga përdorimi i tokave bujqësore, për llogari të z. I. M., përgatitur nga eksperte L. B.; (iv) referencat e përdorura nga ekspertja në përpilimin e raporteve të vlerësimit: 1. vjetari statistikor i Shqipërisë viti 1991; 2. studim "Qëndrueshmëria e disa kultivarëve ulliri autoktonë dhe të huaj ndaj kushteve ekologjike në koleksionin e bazës eksperimentale Shamogjinin", për periudhën e studimit 1998 – 2015; 3. studim mbi shoqërimin tekniko-ekonomik të prodhuesve, domosdoshmëri për zhvillimin bujqësor e rural në vend, prill 2014; 4. disertacion me temë "Studim analitik i kultivarit autokton të ullirit "Kalinjot" në rajonin e Vlorës dhe zona të tjera të Shqipërisë"; 5. katalog i varieteteve kryesore të ullirit olea europea L.ssp sativa në ullikulturën e Shqipërisë; 6. raport vjetor 2018 i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë; 7. studim me temë "Mbrotjtja e ullirit nga miza (Bractocera oleae) me praktika të mira bujqësore", nëntor 2014; 8. material mësimor për lëndën e frutikulturës, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve; (v) deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 15.05.2021 të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, z. T. Sh.; (vi) deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 15.05.2021, të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, z. T. Sh.; (vii) deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 15.05.2021, të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, z. E. M.; (viii) deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 18.05.2021, e shtetasit M. Rr., në lidhje me të ardhurat nga ullishta e z. H. M.; (ix) deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 16.05.2021, e shtetasit M. Rr., në lidhje me të ardhurat nga ullishta e z. I. M.; (x) vërtetim nr. {***} prot., datë 23.06.2021, lëshuar nga Bashkia Patos, në emër të shtetasit I. M.; (xi) vërtetim, datë 23.06.2021, lëshuar nga Bashkia Patos për shtetasin I. M.; (xii) vërtetim nr. {***} prot., datë 23.06.2021, lëshuar nga Bashkia Patos, në emër të shtetasit H. M.; (xiii) vërtetim datë 23.06.2021, lëshuar nga Bashkia Patos për shtetasin H. M.; (xiv) vërtetim, datë 24.06.2021, i kryeplakut të fshatit {***}; (xv) certifikatë familjare, lëshuar më 19.08.2021 nga Njësia Administrative nr. {***} Tiranë; (xvi) certifikatë familjare, lëshuar më 19.08.2021, nga Njësia Administrative nr. {***} Tiranë, (xvii) Shkresë nr. {***} prot., datë 20.08.2021 lëshuar nga Njësia Bashkiake nr. {***}, Tiranë; (xviii) shkresë nr. {***} prot., datë 27.08.2021, e Njesisë Administrative nr. {***}, Fier; (xix) shkresë nr. {***} prot., datë 17.09.2021, e Tirana Bank ShA; (xx) shkresë nr. {***} prot., datë 12.10.2021, e Raiffeisen Bank ShA; (xxi) shkresë nr. {***} prot., datë 14.10.2021, e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë; (xxii) certifikatë familjare, datë 23.11.2021, lëshuar nga Njësia Administrative Patos, për përbërjen e familjes M.; (xxiii) vërtetim nr. {***} prot., datë 06.04.2022, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; (xxiv) shkresë nr. {***} prot., datë 06.04.2022, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier; (xxv) shkresa nr. {***} prot., datë 14.04.2022, e lëshuar nga INSTAT-i mbi të dhënat për ullinjët; (xxvi) shkresë nr. {***}, datë 20.04.2022, lëshuar nga ILDKPKI-ja, bashkëlidhur së cilës vihet në dispozicion

depozituara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe fotografitë e realizuara në tokat ullishte të z. H. M. dhe të z. I. M., të ndodhura në zonën e Patosit, Fier, nëpërmjet kërkesës për depozitim akti të ri shkresor, datë 26.05.2022.

10. Komisionerja Publike, e pyetur gjatë kësaj seance gjyqësore nga trupi gjykues lidhur me vlerën provuese të këtyre akteve shkresore, rezervoi të drejtën të shprehet në konkluzionet përfundimtare. Ndërsa në seancën gjyqësore publike të datës 31.05.2022, me bisedimet përfundimtare⁶, Komisionerja Publike u shpreh se në kushtet kur hetimi ishte shterues dhe i gjithanshëm, bazuar edhe në provat e reja të administruara në Kolegj, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit arrin në nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë dhe, në përfundim, bazuar në nenin F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 241/2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

11. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 71 m², të ndodhur në rr. {***} Tiranë, Komisioneri Publik, në ankim, ka ngritur pretendime sa u përket deklaramëve kontradiktore që subjekti i rivlerësimit ka bërë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, me mundësinë financiare për krijimin e kursimeve dhe depozitave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, si dhe me mundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit I. M., për dhënien hua të shumës 2.000.000 lekë, në shtator 2005. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, trupi gjykues konstaton se:

11.1. Komisioni në vendim është shprehur se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramë të ndryshme lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, por që këto deklaramë nuk cenojnë thelbin e burimit, i cili është me të ardhura nga pagat e subjektit të rivlerësimit. Mospërputhja midis deklaramëve, sipas Komisionit, nuk është pasojë e qëllimit të subjektit për të fshehur apo deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, por e përpjekjes për të detajuar burimin e saj. Nga analiza financiare e kryer, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, për rrjedhojë nuk ngrihen dyshime si dhe nuk provohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur qëllim të deklarojë në mënyrë të pasaktë burimin e saj. Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, burimin e ligjshëm të kësaj pasurie.

11.2. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, konstatoi se apartamenti me sipërfaqe 71 m², ndodhur në rr. {***} Tiranë, është përfituar me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.10.2005, të nënshkruar mes porositëses Irena Maneku dhe shoqërisë sipërmarrëse {***} ShPK, për apartamentin me sipërfaqe totale ndërtimore 80,5 m², në vlerën 45.885 euro. Sipas përcaktimeve të kësaj kontrate, çmimi i apartamentit është likuiduar totalisht ditën e nënshkrimit të kontratës. Palët kontraktore, më datë 12.02.2007, kanë nënshkruar kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme (apartament) nr. {***} rep., nr. {***} kol., për shitjen e këtij apartamenti me sipërfaqe 71 m², në çmimin 45.885 euro, të likuiduar përpara përpilimit të kontratës së shitblerjes jashtë zyrës noteriale.

11.3. Sa u përket deklaramëve periodike të dorëzuara në ILDKPKI, rezulton se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, si vijon: *Blerje apartamenti banimi, sip. ndërtimore 80,5 m², Tiranë me kontratë sipërmarrje në datë*

deklarata e interesave privatë periodikë 2013; (xxvii) raport analize financiare, përpiluar nga audituesi ligjor O. V.; (xxviii) shkresë nr. {***} prot., datë 27.04.2022, lëshuar nga Tirana Bank ShA.

⁶ Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/06/Bisedimet-p%C3%ABrfundimtare-dat%C3%AB-31.5.2022.pdf>.

06.10.2005, në vlerën 45.885 euro. Pjesa takuese: 100 %. Pagesa për blerjen e apartamentit është bërë:

- tërheqje depozite nga Tirana Bank, 800.000 lekë [pjesa që zotëron 100%];
- tërheqje depozite nga Banka e Kursimeve, 93.000 lekë [pjesa që zotëron 100%];
- kursime të vitit 2005, 15.000 euro [pjesa që zotëron 50%];
- tërheqje dhe mbyllje e depozitës nga Banka Amerikane; pjesa që zotëroja 4.000 dollarë [pjesa takuese, 100%].

Po në këtë deklaratë, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *detyrim për blerjen e apartamentit ndaj vëllait tim I. M., shuma totale e detyrimit “20.000 euro”*.

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi apartamentin me sipërfaqe 71 m², ndodhur në rr. {***}, Tiranë, përfituar me kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.10.2005, për të cilin pronësia i ka kaluar në vitin 2007 me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.02.2007. Regjistruar në ZRPP Tiranë, me certifikatë për vërtetim pronësie, datë 25.04.2007, me nr. {***}. Pjesa takuese: 100%. Si burim i krijimit, deklaroi: *të ardhurat nga paga të kursyera gjatë viteve, si dhe huaja prej 2.000.000 lekësh marrë të tretëve*.

11.4. Referuar kontratës së sipërmarrjes, datë 06.10.2005, pagesa e plotë e çmimit prej 45.885 eurosh është likuiduar në momentin e nënshkrimit të saj, si dhe deklarimeve të subjektit në deklaratën e interesave privatë 2005 që, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016⁷, përdoret si provë, sipas Komisionerit Publik në ankim, analiza financiare, për çdo zë të ardhurash të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim për krijimin e kësaj pasurie, do të shtrihet nga momenti i krijimit të burimeve të deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit deri në tetor 2005, kur është blerë apartamenti. Për këtë arsye, shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, të cilat do të trajtohen në vijim në këtë vendim, i referohen burimit të krijimit të deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005. Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e krijimit të shumës 45.885 euro, paguar nga subjekti i rivlerësimit më datë 06.10.2005, sipas përcaktimit në kontratën e sipërmarrjes, mbështetur në dokumentacionin provues, si dhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, duke analizuar në të njëjtën kohë pretendimet e ngritura nga Komisioneri Publik në ankim në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, sipas datës së krijimit të depozitave.

- 12.** Sa i përket, *tërheqje depozite nga Banka e Kursimeve 93.000 lekë*, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se Raiffeisen Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2019, nuk e konfirmon këtë llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas analizimit të akteve të administruara në dosjen gjyqësore, konstaton se:

12.1. Kjo depozitë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në *deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003: depozitë bankare 0.093 milionë lekë, në Bankën e Kursimeve*, me burim krijimi: *kursime nga puna*. Në informacionin e përcjellë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2019, Raiffeisen Bank ShA nuk konfirmon që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë klient i kësaj banke.

12.2. Për këtë pretendim të Komisionerit Publik, me parashtrimet në Kolegji, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës, shkresën nr. {***} prot., datë 12.10.2021, të kësaj banke, sipas së cilës nuk kanë rezultuar të dhëna për depozitën e kursimit në emër të znj. Irena H. Maneku, por është theksuar se dokumentacioni arkivor i degës së ish-Bankës së

⁷ Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitit”.

Kursimeve Fier, sa u përket depozitave të kursimit, nuk është i plotë. Subjekti i rivlerësimit parashtron se ka deklaruar saktësisht në deklaratat e pasurisë të viteve 2003 dhe 2005 depozitat bankare të poseduara dhe, në kushtet kur banka nuk disponon dokumentacion të plotë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi objektive si parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁸.

12.3. Në kushtet kur në dosjen gjyqësore nuk gjendet i administruar dokument që të provojë likuiditetet në emër të subjektit të rivlerësimit në shumën 93.000 lekë në Raiffeisen Bank ShA, edhe pse deklaruar në deklaratat e pasurisë të viteve 2003 dhe 2005, kjo shumë nuk u konsiderua në analizën financiare në Kolegj, pasi gjatë hetimit administrativ në Komision, kjo depozitë nuk u pretendua nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për blerjen e apartamentit, sikurse u pretenduan dy depozitat e tjera në emër të tij, në Tirana Bank ShA dhe Intesa SanPaolo Bank ShA.

12.4. Si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar si burim për blerjen apartamentit, kursimet nga të ardhurat nga pagat, si më poshtë: i) depozitë në bankën *Intesa San Paolo ShA* (ish-Banka Amerikane), në shumën 23.885 USD; ii) llogaria bankare në Tirana Bank ShA, në shumën 1.712.551 lekë, tërhequr në datën 5 tetor 2005; si dhe iii) hua në shumën 2.000.000 lekë, marrë vëllait I. M.

13. Lidhur me *depozitën në bankën Intesa San Paolo ShA, në shumën 23.000 USD*, Komisioneri Publik në ankim pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaratime kontradiktore gjatë hetimit administrativ, krahasuar me deklaratimet në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2004, lidhur me pjesën kontribuuese të tij në këtë depozitë. Po kështu, Komisioneri pretendon se në kushtet kur veprimi i parë bankar lidhur me shumën 23.000 USD mban datën 05.04.2002, shtuar nga interesat bankarë deri në momentin e tërheqjes në vitin 2005, analiza financiare për mundësinë e krijimit të depozitës, duhej të ishte shtrirë deri në datën e veprimit të parë bankar, më 05.04.2020.

13.1. Lidhur me deklaratimet kontradiktore të pretenduara në ankim, nga analizimi i akteve të dosjes, trupi gjyqësor konstaton se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *depozitë bankare, lekë të kthyer në dollarë, të kursyer nga puna ime, janë 4.000 USD, vlera e pasurisë 23.000 dollarë amerikanë, pjesa që zotëron 4.000 dollarë amerikanë, viti i krijimit të pasurisë 2004*. Në rubrikën “Informacion konfidencial”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *në emrin tim është një depozitë bankare pa afat, të cilat janë të familjes sime të origjinës, depozitë mbi të cilën unë veproj në emër dhe për llogari të prindërve të mi pensionistë dhe dy vëllezërve në emigracion. Banka Amerikane, viti i regjistrimit të pasurisë 2004*. Gjithashtu, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi si një nga burimet e krijimit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 71 m²: *tërheqje dhe mbyllje e depozitës Banka Amerikane, pjesa që zotëroja 4.000 dollarë [pjesa takuese, 100 %]*.

13.2. Si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo depozitë është krijuar nga të ardhurat e pagës së saj ndër vite, duke filluar që nga viti 1993 deri në dhjetor 2005. Subjekti i rivlerësimit sqaron se gjatë kësaj periudhe ka jetuar me prindërit, në një ekonomi të përbashkët. Për këtë arsye, depozitën 23.000 USD, e ka deklaruar si kursime nga të ardhurat familjare në deklaratën e

⁸ Neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkak të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”.

interesave privatë të vitit 2004. Deklarimi se 4.000 USD është kontribut i subjektit, ndërsa pjesa tjetër i përket familjes së origjinës, është një pakujdesi, pasi ka dashur të shprehë të kundërtën, 4.000 USD nga të ardhurat e prindërve dhe pjesa tjetër nga pagat e tij. Prindërit, sipas subjektit, i kishin mundësuar për të kursyer të gjithë pagën, pasi kishin të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet. Në momentin e shkëputjes nga familja, prindërit i kanë lënë subjektit të gjithë shumën e depozituar në këtë llogari, pasi ato ishin kryesisht të ardhurat nga pagat e saj, që zinin 83% të depozitës, ndërsa pjesa tjetër, *e ardhur e realizuar nga pasuria tokë ullishte në pronësi të babait, qiradhënia e objektit ish-Komuna {***} në pronësi të tij, si dhe shuma 570.000 lekë e përfutur nga shitja e makinës së vëllait të subjektit I. M., dhuruar prindërve, në vitin 1998*. Në këtë lloj situatë, me ekonomi të përbashkët, subjekti konsideron edhe pagën e tij, si kontribut dhe të ardhura familjare për faktin se shkaku i kursimit të plotë të pagës së tij, kanë qenë pikërisht të ardhurat dhe kontributi i familjarëve të tjerë. Në këtë mënyrë, sipas subjektit të rivlerësimit, shpjegohet lapsusi në deklaratën e interesave privatë 2004 dhe qëndrueshmëria në deklaratimet vijuese për këtë gjetje, ku është keqkuptuar kontributi familjar me kontributin e subjektit në kursimet e krijuara si pajë, në gjirin e familjes së origjinës.

13.3. Për sa parashtruar më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në qëndrimet e mbajtura në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004 me deklaratimet e bëra gjatë hetimit administrativ në Komision, fakt i pranuar tashmë nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet e depozituara në Kolegj. Në kushtet kur në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të apartamentit me sipërfaqe 71 m², të ndodhur në rr. {***}, Tiranë, të ardhurat nga pagat dhe huan e marrë nga i vëllai, Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, përllogarit totalin [shumatoren] e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit nga pagat, për periudhën nga dita e punësimit 13.05.1993 deri më 05.04.2002, që rezultoi në vlerën 2.567.740 lekë, apo 19.109 USD, konvertuar me kursin e këmbimit ALL/USD të çdo viti, përkatësisht. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar saktë burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

13.4. Në mbështetje të qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, se pasaktësia në deklaratim, nuk sjell aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kur nuk shoqërohet me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vijim është trajtuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të krijuar depozitën 23.000 USD, në prill të vitit 2002, e verifikuar në kuadër të ekonomisë së përbashkët me anëtarët e tjerë të familjes.

13.5. Gjatë hetimit administrativ në Komision, u administrua shkresa nr. {***} prot., datë 06.11.2019, e përcjellë nga Intesa Sanpaolo Bank ShA, në të cilën rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Maneku, ka pasur llogari pranë kësaj banke me nr. {***} (*Base Number*). Sipas kopjes së *deposit debit advice* bashkëlidhur kësaj shkrese, çelja e depozitës në shumën 23.000 USD, pranë ish-Bankës Amerikane të Shqipërisë, është bërë më datë 05.04.2002. Kjo depozitë është tërhequr më 06.10.2005, në vlerën 23.884,66 USD. Në kushtet kur depozita bankare është hapur më 05.04.2002, ndryshe nga Komisioni i cili ka verifikuar mundësinë financiare të subjektit dhe të anëtarëve të familjes në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, deri në fund të vitit 2003, trupi gjykues ka vlerësuar të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik që analiza financiare të shtrihet deri në datën e depozitimit në bankë të shumës 23.000 USD, më 05.04.2002.

13.6. Komisioneri Publik, në ankim, ngre pretendimin që të ardhurat e subjektit të rivlerësimit deri në datën 05.04.2002, janë në shumën 2.448.511 lekë, ndërsa kursimet në emër të tij në sistemin bankar, në shumën 4.343.097 lekë⁹, pra më të larta se të ardhurat. Në analizim

⁹ *Kundërvlera e depozitës 23.000 USD [dollarë amerikanë] në ALL [lekë], konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë më datë 05.04.2002, 1 USD = 143,15 ALL, si dhe kundërvlera e depozitës së subjektit të rivlerësimit*

të këtij shkaku ankimor, referuar informacionit të përcjellë në Komision nga Tirana Bank ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 05.11.2019, rezulton se znj. Irena Maneku ka pasur llogari pranë kësaj banke në monedhën lek dhe dollarë amerikanë, aktive gjatë periudhës 2001-2005. Nga lëvizjet e llogarisë bankare përcjellë me këtë shkresë, rezulton se në tetor të vitit 2001, subjekti i rivlerësimit ka pasur të depozituar shumën 7.530 USD, konvertuar në 1.031.610 lekë. Për këtë shumë, nuk rezulton që Komisioni t'i ketë kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për burimin e ligjshëm të të ardhurave përdorur për krijimin e saj, ndërkohë që e ka përfshirë në analizën financiare të kryer me rezultatet e hetimit administrativ, si gjendje likuiditetesh, për vitin 2001, në vlerën 1.046.946 lekë, përfshirë interesat bankarë të përfituar gjatë këtij viti.

13.7. Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ka pasur depozitë bankare në Tirana Bank ShA në vitin 2001, me burim krijimi, përveç të ardhurave të tjera, edhe të ardhurat e përfituara në shumën 1.100.000 lekë nga shitja e tokës me sipërfaqe 1000 m². Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka depozituar me parashtrimet deklaratën noteriale nr. {***} regj., datë 10.02.1998, nëpërmjet së cilës z. H. M. i shtet tokën arë me sipërfaqe 1000 m², blerësit R. M., kundrejt çmimit 1.300.000 lekë, prej të cilave 1.100.000 lekë janë dorëzuar në dorë me firmosjen e deklaratës, ndërsa pjesa tjetër prej 200.000 lekësh do të dorëzohet me nënshkrimin e kontratës noteriale të shitjes së tokës, me regjistrimin e saj. Sipas sqarimeve të subjektit të rivlerësimit në *parashtrime*, nuk është bërë kontrata e shitblerjes për këtë pasuri, për shkak se toka nuk është regjistruar ende. Trupi gjykues vlerësoi të përfshijë në analizën financiare shumën prej 1.100.000 lekësh.

13.8. Komisioneri Publik gjithashtu pretendon se, nga aktet në dosje, provohet edhe blerja e apartamentit në Fier nga vëllai i subjektit A. M., më 18.01.2000, në vlerën 1.800.000 lekë, vlerë e cila duket se nuk është përfshirë në zërin shpenzime, në analizën e Komisionit. Ky apartament është deklaruar si adresë banimi në deklaratat e interesave privatë të viteve 2003, 2004 dhe 2005. Sipas Komisionerit Publik, vetëm shuma e investimeve në pasuri të paluajtshme dhe kursime të depozituara në sistemin bankar deri në prill 2002 (pa llogaritur shpenzime minimale jetese për një familje me 4 persona, për periudhën 1993 – 2002) është në shumën 6.143.097 lekë [4.343.097 lekë kursime në sistemin bankar + 1.800.000 lekë apartamenti i z. A. M.], ndjeshëm më e lartë sesa të ardhurat e dokumentuara.

13.9. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit A. M. ka regjistruar më datë 18.01.2000, apartamentin me sipërfaqe 54,6 m², të ndodhur në lagjen {***}, Fier, p. {***}, shk. {***}, ap. {***}, blerë në vlerën 1.800.000 lekë. Më pas, nëpërmjet *kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme (apartament) nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 10.09.2005, apartamenti u është shitur* në vlerën 2.000.000 lekë, shtetasve I. dhe Sh. H. Sa i përket burimit financiar për blerjen e këtij apartamenti, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore: i) nuk rezulton të jenë administruar të dhëna për të ardhurat e z. A. M.; ii) ky apartament rezulton i shitur më datë 10 shtator 2005, në vlerën 2.000.000 lekë dhe të ardhurat nga shitja e tij nuk janë deklaruar dhe pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për apartamentin e blerë nga subjekti i rivlerësimit thuajse një muaj më pas, më 6 tetor 2005; iii) subjektit të rivlerësimit nuk i ka kaluar barrë prove mbi pasurinë apartament, në pronësi të vëllait A. M.

13.10. Me parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit sqaron se nëse u qëndrojmë pretendimeve të Komisionerit Publik, që shuma 1.800.000 lekë duhet të përfshihet në analizën financiare për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e depozitave, atëherë shuma 2.000.000 lekë, e përfituar në vitin 2005 nga shitja e këtij

aktive në dollarë pranë Tirana Bank ShA, e çelur në vitin 2001, konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2001.

apartamenti, duhet të përfshihet në analizën financiare të kryer për blerjen e apartamentit. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu pretendon se në asnjë moment të këtij procesi apo edhe më parë, nuk ka deklaruar si burim krijimi të apartamentit të tij në Tiranë, të ardhurat e realizuara nga shitja e apartamentit në Fier nga i vëllai A. M.

13.11. Në përbërjen familjare të datës 29.07.2004, provuar nëpërmjet certifikatës familjare, datë 23.11.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Patos, rezulton se A. M. ka qenë anëtar i familjes M. në kohën e blerjes së këtij apartamenti, së bashku me prindërit dhe subjektin e rivlerësimit. Pavarësisht faktit se në dosjen gjyqësore nuk disponohet dokumentacion për të ardhurat e z. A. M., si për faktin se të ardhurat nga shitja e apartamentit të tij në më pak se një muaj përpara blerjes së apartamentit objekt shqyrtimi, nuk janë pretenduar të kenë shërbyer si burim krijimi, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, shpenzimet për blerjen e apartamentit në emër të z. A. M. në vitin 2001, u përfshinë në analizën financiare të kryer në Kolegj.

13.12. Lidhur me burimin e krijimit të depozitës 23.000 USD, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kanë shërbyer kursimet e tij nga paga dhe një pjesë shumë e vogël, gati 4.000 USD, kanë qenë të ardhura nga prindërit, me burim nga qiraja e objektit që shfrytëzohej si godinë nga ish-Komuna {***}, të ardhura nga pensioni dhe pagat e prindërve, si dhe të ardhurat nga produktet bujqësore [përfutur tokë ullishte me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”) nr. {***}, datë 30.07.1993, në bazë të ligjit nr. {***}, datë 19.07.1991, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. H. M]. Për të provuar të ardhurat e mjaftueshme të prindërve, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision dokumentacion justifikues ligjor, konkretisht për të ardhurat nga kontrata e qirasë me Komunën {***}¹⁰, dhuratën që vëllai [I. M.] u kishte bërë prindërve në vitin 1998, në vlerën 570.000 lekë, të përfutur nga shitja e automjetit, si dhe dokumentacion të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Fier, për të ardhurat nga pensionet e prindërve.

13.13. Lidhur me të ardhurat e përfutuara nga babai i subjektit prej *shfrytëzimit të ullishtave*, në ankim Komisioneri Publik vlerëson se këto të ardhura për periudhën 1994-2005, mbështeten në aktekspertim privat dhe në deklarata të thjeshta pa datë të disa shtetasve, nuk bazohen në dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Komisioneri Publik kërkon një qëndrim të qartë dhe ligjor të Kolegjit, pasi marrja parasyshe e këtyre akteve/deklaratave do të ndryshonte zërat në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

13.14. Trupi gjyqësor, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, konstaton se familja e z. H. M. nga fshati {***}, Fier, nëpërmjet AMTP nr. {***}, datë 30.07.1993, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, ka përfutur 10.500 m² tokë gjithsej, prej të cilave 9.500 m² sipërfaqe *ullishte* dhe 1.000 m² sipërfaqe *tokë arë*. Po sipas formularit nr. {***}, datë 08.04.1993 [fletë regjistri]¹¹ që disponon arshiva e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (në vijim “DAMT”) e Këshillit të Qarkut Fier, H. M. figuron si përfutues i *ullishtës* me 125 rrënjë ullinj [25 rrënjë *shekullorë* dhe 100 rrënjë *të reja*].

13.15. Për të provuar të ardhurat nga *shfrytëzimi i ullishtës*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur

¹⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.12.2019, të Bashkisë Patos, Njësia Administrative {***}, përcillen urdhërshkrimet dhe mandatpagesat në zbatim të kontratave të qirasë nr. {***}, datë 20.07.1994, nr. {***}, datë 07.10.1994 dhe nr. {***}, datë 20.12.1996, lidhur mes ish-Komunës {***} dhe qiradhënësit H. M., gjithsej 615.275 lekë.

¹¹ Me shënimin: “Njësohet me origjinalin që arshiva e DAMT-së, Këshilli i Qarkut (fotokopje e formularit nr. {***}, Bashkia Patos”, datë 26.11.2019.

një raport vlerësimi¹², i cili referon në standarde ndërkombëtare, literaturë vendase dhe të huaj. Prej tij, rezulton që pronat janë të kushte shumë të mira të ruajtjes e mirëmbajtjes. Për të përlllogaritur rendimentin, në mungesë të dokumentacionit të kohës, janë përdorur të dhënat e INSTAT-it dhe vlerësimi është bërë mbi bazën e rendimentit tipik të varietetit të ullirit.

Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se: i) për periudhën nga viti 1994 deri në vitin 2002, prodhimi i ullirit është përpunuar në një punishte tip i vjetër (ulliri përpunohej me shporta dhe shtypej me gurë) që ndodhej në fshatin {***}, Fier, një ndër të vetmet në zonë, që ishte në pronësi të shtetasit M. Rr.; ii) për periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2010, ulliri është përpunuar në fabrikën që ndodhet në lagjen {***}, pronë e shoqërisë {***} ShPK, me administrator T. Sh. ; iii) për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2014, ulliri është përpunuar në fabrikën e ullirit të shoqërisë {***} ShPK, me administrator E. M. Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka depozituar:

13.15.a. Deklaratë e shtetasit M. R., sipas të cilit: *[...] gjithë zona e Donofrosës, Roskovecit dhe Patosit, e sillnin ullirin pranë nesh për të nxjerrë vaj. Ky aktivitet ka vazhduar deri në fund të vitit 2002. Deklaroj se dhe z. H. M. e ka sjellë ullirin për të bërë vaj në punishten tonë, dhe kjo ka ndodhur nga viti 1993 deri në vitin 2002 [...]. Zona nga vjen ulliri i H. M., është i varietetit “Kalinjot”, me një prodhimtari të lartë prodhimi, duke dhënë nga 27 – 30 kg vaj/për ulli. Aktiviteti ka qenë i regjistruar një periudhë te tatimet, por këto i ndiqte ekonomisti dhe sot nuk disponoj ndonjë dokument që të tregojë për këtë qëllim. Faktin që kjo punishte ka qenë në këtë fshat dhe në zotërimin tim, vërtetohet lehtë në zonë. Nga shënimet që unë kam mbajtur, rezulton se z. H. M. ka sjellë për të përpunuar në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor, sasinë e ullirit që ka pasur dhe ka marrë vaj të prodhuar në total, për çdo vit, si më poshtë: në vitin 1994 ka prodhuar 837 kg vaj, në vitin 1995 ka prodhuar 698 kg vaj, në vitin 1996 ka prodhuar 1312 kg vaj, në vitin 1997 ka prodhuar 965 kg vaj, në vitin 1998 ka prodhuar 1215 kg vaj, në vitin 1999 ka prodhuar 1372 kg vaj, në vitin 2000 ka prodhuar 1482 kg vaj, në vitin 2001 ka prodhuar 1257 kg vaj, në vitin 2002 ka prodhuar 1468 kg vaj.*

13.15.b. Deklaratë e shtetasit T. Sh., përfaqësues ligjor i subjektit {***} ShPK, me aktivitetet “Përpunimin e ullirit, prodhimin e vajit të ullirit, tregtimin e tij etj.”, me fabrikë vaji dhe qendër të zhvillimit të aktivitetit në lagjen {***}, {***}, Bashkia Patos. Në këtë deklaratë, z. Sh. shprehet se: *H. M., me ullishte në lagjen {***}, Patos, që nga viti 2003 e deri në vitin 2011, ka depozituar ullirin në fabrikën e tij, ku një pjesë, sasi të vogël, e ka marrë për ta përdorur vetë dhe pjesën tjetër e ka shitur direkt në fabrikë. Nga H. M., janë dorëzuar ullinj të fabrikë, duke dhënë në vitin me prodhim të lartë 5,5 tonë ullinj dhe ka marrë 1,5 tonë vaj ulliri, dhe në vitet që ka pas më pak ullinj, ka dorëzuar 4,5 tonë ullinj dhe ka marrë 1,3 tonë vaj ulliri, të cilat janë blerë nga viti 2003 – 2007, me një çmim 500 lekë/kg dhe nga viti 2008 – 2010, me një çmim prej 600 lekë/kg. Pagesa për vajin e shitur te ne i është bërë me lekë në dorë, sapo ka dalë vaji në fabrikë (për sasinë e prodhuar e të lënë te ne). Për të dokumentuar të ardhurat e përfituara nga toka ullishte, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur fletëhyrje që i përkasin periudhës 01.11.2003 deri më 28.12.2010, të lëshuara nga administratori i {***} për sasinë e ullirit për përpunim, të depozituar nga z. H. M., por pa specifikuar vlerën e përfituar.*

13.15.c. Deklaratë e shtetasit E. M., përfaqësues ligjor i shoqërisë {***} ShPK, regjistruar më datë 11.04.2011, me aktivitet grumbullimin, ruajtjen, përpunimin e ullirit, vajit të ullirit dhe vajrave të tjerë bimorë etj., me fabrikë vaji në fshatin {***}, {***}, Bashkia Patos. Në këtë deklaratë, z. M. shprehet se H. M. e ka depozituar ullirin në fabrikën e tij që prej ngritjes së saj deri aktualisht. Për të dokumentuar të ardhurat e përfituara, subjekti ka paraqitur disa

¹² “Raport vlerësimi për të ardhurat nga ullishtat e H. M.”, datë 10.12.2019, hartuar nga eksperte L. B., administratore e shoqërisë {***} ShPK, e pajisur ndër të tjera si “Vlerësuese e Shkallës së Dytë “Për vlerësimin e tokës bujqësore, tokë pyjore, kullotë livadhe dhe tokë të pafrytshme” me nr. {***}, datë 29.10.2018.

mandatpagesa të lëshuara nga kjo shoqëri për z. H. M., për shumën e përfiturar *si likuidim për vajin e ullirit*, për periudhën 25.10.2011 deri më 25.11.2014.

13.16. Në përgjigje të pretendimeve të Komisionerit Publik në ankim, se këto të ardhura për periudhën 1994-2005, mbështeten në aktekspertim privat dhe në deklarata të thjeshta pa datë të disa shtetasve, nuk bazohen në dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave, të pretenduara të realizuara, subjekti i rivlerësimit me parashtrimet, depoziton në Kolegj:

1. deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 18.05.2021, e shtetasit M. Rr., në lidhje me të ardhurat nga ulla të z. H. M., shoqëruar me: i) deklaratën e mëparshme [jonoteriale]; ii) fletë nga blloku i shënimeve të tij;
2. deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 16.05.2021, e shtetasit M. Rr., në lidhje me të ardhurat nga ulla të z. I. M., shoqëruar me: i) deklaratën e mëparshme [jonoteriale]; ii) fletë nga blloku i shënimeve të tij;
3. deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 15.05.2021, e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, z. T. Sh., për prodhimin e ullishtave të z. H. M., shoqëruar me: i) deklaratën e depozituar nga subjekti në Komision; ii) fletëhyrjet e lëshuara nga data 01.11.2003 deri më 28.12.2010; iii) ekstrakt historik i shoqërisë, i nënshkruar elektronikisht nga QKB;
4. deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 15.05.2021, e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, z. T. Sh., për prodhimin e ullishtave të z. I. M., shoqëruar me: i) deklaratën e depozituar nga subjekti në Komision; ii) fletëhyrjet e lëshuara nga data 07.11.2003 deri më dhjetor 2006; iii) ekstrakt historik i shoqërisë, i nënshkruar elektronikisht nga QKB;
5. deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 15.05.2021, e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, z. E. M., për prodhimin e ullishtave të z. H. M., shoqëruar me: i) deklaratën e depozituar nga subjekti në Komision; ii) mandatpagesat e lëshuara nga viti 2011 – 2014, të depozituara në Komision; iii) ekstrakti historik i shoqërisë, i nënshkruar elektronikisht nga QKB-ja [me status aktiv]; iv) certifikatat e regjistrimit si person i tatueshëm; v) leja mjedisore e lëshuar nga QKB-ja; vi) certifikatë regjistrimi nga shoqëria e huaj {***}.

13.17. Në kushtet e mungesës së një dokumentacioni të plotë mbi masën reale të të ardhurave të përfituara nga shfrytëzimi i ullishtave, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se pronësia e babait të subjektit të rivlerësimit me mbi 125 rrënjë ullinj [25 janë rrënjë shekullore dhe 100 rrënjë të reja], është e provuar me AMTP nr. {***} të vitit 1993 dhe formularin nr. {***}, datë 08.04.1993, që disponon arkiva e DAMT-së të Këshillit të Qarkut Fier. Pavarësisht se këto prona, nuk janë të regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Fier¹³, sipas informacionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.04.2022, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, këto prona nuk kanë qenë objekt kontestimi në gjykatë.

13.18. Ndodhur në kushtet kur të dhënat mbi të ardhurat, sipas deklaratave të prodhuesve të vajit të ullirit, z. M. R. dhe përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk shoqërohen me dokumentacion të plotë provues financiar/kontabël [fletë nga libër xhiro, disa fletë-dalje e fletë-hyrje], trupi gjykues vlerëson se duhen mbajtur në konsideratë përlllogaritjet në *Raport vlerësimi për të ardhurat nga ulla të z. H. M., datë 10.12.2019*, përgatitur nga ekspertja e licencuar L. B., administratore e {***} ShPK, të mbështetura mbi baza shkencore, lehtësisht të aksesueshme në burime të hapura, të tilla si: i) raport vjetor 2018 i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë¹⁴; ii) punime

¹³ Në shkresën nr. {***} prot., datë 29.03.2019, të ZVRPP Fier, dhe shkresën nr. {***} prot., datë 12.11.2019, nuk konfirmohet e regjistruar kjo pronë, ndërkohë që sqarohet se ZVRPP Fier nuk disponon regjistrimet para marsit 1997, pasi regjistrat e hipotekës janë djegur gjatë trazirave të këtij viti.

¹⁴ <http://attcvlore.al/wp-content/uploads/2019/05/Raporti-Vjetor-2018.pdf>.

shkencore të publikuara/doktoratë¹⁵; iii) informacion nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve¹⁶, dhe të dhëna zyrtare të INSTAT-it¹⁷, si dhe të dhëna statistikore; iv) shkresë nr. {***} prot., datë 14.10.2021, e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë [Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural], në të cilën përcaktohen të dhënat e prodhimit të llojit të ullirit “Kalinjot”, sipas vendndodhjes dhe vjetërsisë së tyre, shpenzimet për mirëmbajtje dhe çmimi për periudhat 1993 – 2000, 2001 – 2010, dhe 2011 e në vazhdim; si dhe v) shkresë nr. {***} prot., datë 14.04.2022, e lëshuar nga INSTAT-i.

13.19. Sa i përket përmbushjes së kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës¹⁸, Komisioni në paragrafin 24.8.10 të vendimit objekt shqyrtimi, arsyeton mungesën e parashikimit të detyrimit tatimor për të ardhurat e përfituara nga vetëpunësimi në bujqësi, pasi referuar legjislacionit në fuqi, nga viti 1994 e deri aktualisht, vetëm toka bujqësore është objekt taksimi dhe jo të ardhurat që gjeneron ajo. Fermerët, sipas Komisionit, nuk deklarojnë të ardhura mbi produktet e tyre. Pas vitit 2012, në legjislacion u përfshi skema e rimbursimit e TVSh-së për fermerin, nëpërmjet së cilës fermerët që kërkonin rimbursim të TVSh-së, duhet të deklaroheshin shitet e tyre. Në llogaritjen e të ardhurave nga ullinjët në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e INSTAT-it. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i legjislacionit të zbatueshëm, nuk evidenton dispozita ligjore që të kategorizojnë të ardhurat nga shfrytëzimi i ullishtave, si të ardhura të tatueshme. Detyrimi që prodhuesit e produkteve bujqësore, në këtë rast kultivuesit e ullirit, kanë kundrejt organeve shtetërore, janë taksat vendore për tokën bujqësore, të parashikuara nga neni 9, pika 2 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për të provuar shlyerjen e taksave vendore për tokën bujqësore, me parashtrimet në Kolegj, subjekti depozitoi vërtetime të lëshuara nga Bashkia Patos, që provojnë se H. dhe I. M. kanë paguar taksën e tokës bujqësore deri më datë 31.12.2021.

13.20. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vendosi të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga ullishtat, sipas llogaritjeve në *Raport vlerësimi për të ardhurat nga ullishtat e H. M., datë 10.12.2019*, pasi çmon se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e familjes M., në harmoni me njëra-tjetrën, provojnë bindshëm që kjo familje ka përfituar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë të ardhura nga shfrytëzimi i ullishtave. Analiza financiare e kryer në Kolegj, duke përfshirë si arsyetuar më sipër në këtë vendim, edhe shpenzimet për blerjen e apartamentit në vitin 2000 në emër të z. A. M., gjendjen e likuiditeteve në Tirana Bank ShA në vitin 2001, si dhe shpenzimet jetike për 4 anëtarë, tregoi se subjekti i rivlerësimit, si anëtar i familjes M., justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme, krijimin e depozitës 23.000 USD më datë 05.04.2002.

- 14.** Lidhur me depozitën në Tirana Bank ShA, në shumën 800.000 lekë, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, nuk rezulton të ketë deklaruar shtesat në depozitën pranë Tirana Bank ShA dhe destinacionin e shumës së tërhequr në dhjetor 2004, prej 1.254.484 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në

¹⁵ Disertacion: “Studimi analitik i kultivarit autokton të ullirit “Kalinjot” në rajonin e Vlorës dhe zona të tjera të Shqipërisë”, me autore S. V., publikuar në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës: https://api.fshn.edu.al/uploads/S.V._Doktorature_Kimi_Industriale_48876e4f1d.pdf

¹⁶ Katalog i varieteteve kryesore të ullirit olea europea L.ssp sativa në ullikulturën e Shqipërisë: <http://qrgj.org/wp-content/uploads/>

¹⁷ http://www.instat.gov.al/media/6230/vjetari-statistikor-i-shqiperise-1991_.pdf

¹⁸ Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, kursimet e poseduara në *cash* në vitin 2004 dhe, si rrjedhojë, nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme shuma prej 1.700.000 lekësh, e deklaruar si pagesë për blerjen e këtij apartamenti. Për këtë pretendim, Komisioneri Publik i referohet jurisprudencës së Kolegjit në vendimet¹⁹ e juridiksionit të rivlerësimit. Trupi gjykues, në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton:

14.1. Komisioni në vendim shprehet²⁰ se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë në përputhje me transaksionet bankare, që janë lehtësisht të gjurmueshme dhe të verifikueshme. Subjekti, sipas Komisionit, ka deklaruar rregullisht të ardhurat e tij nga paga dhe të gjitha veprimet i ka kryer nëpërmjet bankës dhe krijon bindjen e mbështetur në prova se mosdeklarimi i shtesës së të ardhurave në shumën 454.484 lekë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, nuk përbën mungesë të burimeve financiare për blerjen e apartamentit. Komisioni, në arrijtjen e këtij konkluzioni, mbështetet në faktin se nga ana e subjektit të rivlerësimit, llogaria bankare në të cilën është tërhequr shuma 454.484 lekë, është deklaruar në DVP/2003, gjithashtu edhe si burim për blerjen e apartamentit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005. Subjekti i rivlerësimit ka kryer tërheqjen e kësaj shume në fund të vitit 2004, dhe e ka rikthyer sërish në bankë në datën 13.09.2005, duke shtuar dhe kursimet e vitit 2005.

14.2. Në analizë të shkakut ankimor, u shqyrtuan lëvizjet e llogarisë bankare në lekë, të përcjella nga Tirana Bank ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 08.03.2019, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Maneku, ka hapur një depozitë më datë 22.09.2003, në vlerën 800.000 lekë [llogaria nr. {***}]. Këtë depozitë bankare, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, në vitin 2003, *depozitë bankare pranë Tirana Bank, në vlerën 800.000 lekë, me burim: kursime nga puna*. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, si burim krijimi për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *tërheqje depozite nga "Tirana Bank", shuma 800.000 lekë*.

14.3. Referuar lëvizjeve në llogarinë bankare në lekë, të përcjella me shkresën e sipërcituar, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë depozituar [kredituar llogarinë nr. {***}] më datë 23.02.2004, shumën 200.000 lekë, dhe më 05.05.2004, shumën 200.000 lekë. Ndërkohë rezulton të ketë tërhequr më datë 23.11.2004, shumën 200.000 lekë; më datë 01.12.2004, shumën 654.484 lekë; dhe më datë 23.12.2004, shumën 400.000 lekë. Pra, në total, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në fund të vitit 2004, shumën prej 1.254.484 lekësh. Shumën prej 454.484 lekësh [të përbërë nga dy kreditimet prej 200.000 lekësh secili, si dhe interesat bankarë], subjekti i rivlerësimit nuk rezulton ta ketë deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 4, germa "d" e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003²¹.

14.4. Në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në datën 23.12.2004, ka mbyllur depozitën me afat duke tërhequr *cash* shumën 1.254.484 lekë, me qëllim blerjen e apartamentit, por për vonesa në ndërtim të ndërtuesit, kjo shumë është likuiduar në tetor të vitit 2005, kur është realizuar dhe lidhja e kontratës së sipërmarrjes. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, për sa kohë këto *para* nuk kishin shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie, fakti që ndodheshin në bankë apo në banesë, nuk përbënte në vlerësimin e saj, arsye deklarimi. Në lidhje me shtesat në këtë llogari gjatë vitit 2004, që së bashku me interesat bankarë arrijnë

¹⁹ Shih vendimet (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39; nr. 11/2019, paragrafi 27.12.18; nr. 19/2019, paragrafi 84; nr. 20/2019, paragrafët 55 e 56; nr. 29/2019, paragrafi 31.

²⁰ Shih paragrafin 24.7.5 të vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

²¹ Neni 4, germa "d" e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje ne çash, në llogari rrjedhëse, në depozite, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj".

shumën 454.484 lekë, nuk janë deklaruar, duke menduar se burimi i kësaj llogarie, paga, ishte deklaruar në rubrikën e të ardhurave në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004. Transaksionet bankare ishin tejet transparente, të gjurmueshme dhe lehtësisht të verifikueshme, mosdeklarimi në rubrikën e duhur, nuk duhet të përbëjë shkak për deklarim të pasaktë apo të pamjaftueshëm, por një parregullsi formale që nuk ka sjellë asnjë pasojë, pasi provohet pa asnjë kundërshtim, burimi i ligjshëm i shtesës [në shumën 454.484 lekë]. Duke qenë se ndërtuesi ishte në vonesë, për të mos i mbajtur në shtëpi, subjekti i rivlerësimit sqaron se shuma prej 1.254.484 lekësh, e tërhequr në fund të vitit 2004, së bashku me kursimet e vitit 2005 prej 500.000 lekësh, janë ridepozituar sërish në bankë më datë 14.09.2005, për t'i tërhequr më 05.10.2005, në shumën totale prej 1.712.551 lekësh, një ditë përpara kryerjes së pagesës dhe lidhjes së kontratës, duke e mbyllur këtë llogari.

14.5. Referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr. 7/2019, paragrafi 39; nr. 11/2019, paragrafi 27.12.18; nr. 19/2019, paragrafi 84; nr. 20/2019, paragrafët 55 e 56; nr. 29/2019, paragrafi 31, të cilat Komisioneri Publik i sjell në vëmendje për të mbështetur pretendimin e tij, trupi gjykues vëren se i përkasin qëndrimin të mbajtur nga Kolegji lidhur me mosmarrjen në analizë të gjendjes *cash*, për sa kohë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Për këtë fakt, Kolegji ka orientuar në bazë të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash*, si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.

14.6. Sa i përket kursimit në shumën 454.484 lekë në vitin 2004, të padeklaruara në deklaratën e interesave privatë të këtij viti, referuar detyrimin të parashikuar në nenin 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë edhe vlerën e likuiditeteve në gjendje *cash*, si për çdo pasuri tjetër. Deklarimi në vitin 2004 i kursimeve të këtij viti, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të rivlerësimit, do të konsiderohej provë për të provuar ekzistencën e tyre. Megjithatë, në rastin konkret, në lidhje me mosdeklarimin e kursimit në shumën 454.484 lekë, trupi gjykues çmon të mbajë në konsideratë faktin se, gjendja e kësaj shume deri në fund të vitit 2004, ka qenë *likuiditet në bankë*, provuar nga Tirana Bank ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 08.03.2019. Gjithashtu, për periudhën nga tërheqja deri më datë 31.12.2004, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë krijuar pasuri, duke pretenduar këtë shumë si burim, si dhe faktin se shuma prej 1.254.484 lekësh është një shumë e konsiderueshme për t'u shpenzuar në pak ditë.

14.7. Trupi gjykues, në koherencë me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën²² e tij, se pasaktësitë në deklaratimet periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, si anëtar i familjes së origjinës, në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme, krijimin e depozitës në Tirana Bank ShA, në shumën 800.000 lekë, të krijuar më 19 shtator 2003, si dhe kursimet në vitin 2004, në shumën 454.484 lekë.

- 15.** Mbi shumën 15.000 euro kursime të vitit 2005, të deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2005, Komisioneri Publik pretendon se sa i përket burimit të krijimit të kësaj shume, ka mospërputhje të deklarimeve në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaratën e interesave privatë 2005, ballafaquar me deklaratimet para ILDKPKI-së dhe ato gjatë hetimit administrativ. Sipas Komisionerit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, burimi i apartamentit 71 m², nuk është deklaruar saktësisht dhe plotësisht, pasi nuk është deklaruar shuma prej 15.000 eurosh. Në analizë të

²² Shih vendimet (JR) nr. 33/2021 dhe nr. 37/2021.

burimit të deklaruar (15.000 euro kursime nga pagat e subjektit për vitin 2005), rezulton se të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën janar deri 6 tetor 2005, janë rreth 685.000 lekë dhe nuk mbulojnë kursimin e deklaruar në shumën 15.000 euro.

15.1. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, si një nga burimet e përdorura për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *kursime të vitit 2005, në vlerën 15.000 euro*. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni ka administruar ndër të tjera dhe procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja mbi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, datë 02.10.2014, ku pyetjes së inspektorëve *se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, keni deklaruar se për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vlerën 45.885 euro, është shfrytëzuar edhe një kursim prej 15.000 eurosh ndër vite, likuiditeti cash, i padeklaruar më parë*, subjekti i është përgjigjur se: *për sa i përket likuiditetit cash, sqaroj se një pjesë kanë qenë kursimet e atij viti, një pjesë ka qenë kontribut i ish-bashkëjetuesit tim dhe një pjesë tjetër ka qenë dhuratë që më bënë prindërit për blerjen e apartamentit, me rastin e futjes në apartamentin e ri, në nëntor të vitit 2005*. Në këto kushte, në pyetësorin e datës 4.12.2019, Komisioni i kërkon subjektit të shpjegojë arsyen përse nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim për blerjen e këtij apartamenti, të ardhurat e z. S. Gj. dhe dhuratën e prindërve të saj, si dhe kontributin e tyre respektivisht për blerjen e apartamentit, shoqëruar me dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e tij, sqaron se nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si burim as të ardhurat e z. Gj. dhe as të familjes, për arsye se deri në dhjetor të vitit 2005, ka jetuar së bashku me prindërit, dhe kontributi i tyre në blerjen e apartamentit ka qenë fakti që nuk ka kryer shpenzime jetike. Çdo e ardhur e pagës kursehej për llogari të tij, pasi shpenzimet janë përballuar nga të ardhurat e prindërve, dhurata të vëllait, të ardhura nga qiraja e objektit *Komuna {***}*, Fier, si dhe prodhimet e ullishtës etj. Ndërsa sa i përket kontributit të bashkëshortit, ashtu siç ka deklaruar në procesverbalin e mbajtur më datë 2.10.2014 në ILDKPKI, që nga dhjetori i vitit 2005 ka filluar të bashkëjetojë me të, dhe ai ka kontribuar në kryerjen e shpenzimeve jetike apo në formën e dhuratave simbolike që ka bërë në atë periudhë. [...] dhe i është referuar kontributit të tij për kohën që filluan bashkëjetesën.

15.2. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe parashtrimeve në Kolegj, ka shpjeguar se nuk ka mospërputhje të deklarimeve të saj në deklaratën e interesave privatë 2005, me deklarimet e bëra pranë ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të vitit 2014 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit parashtron se të ardhurat nga pagat e tij dhe huaja e marrë nga i vëllai përbëjnë burimin fillestar dhe të vetëm të krijimit të kësaj pasurie, pasi qoftë në formë depozite, qoftë në *cash*, zanafilla e krijimit mbeten pagat. Mospërputhja midis deklarimeve nuk ka ardhur si pasojë e qëllimit për të fshehur apo deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, por përshkrimi në deklaratën e interesave privatë 2005, është bërë në mënyrë më analitike për efekt transparence. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma 15.000 euro përbëhet nga shuma 800.000 lekë, depozituar në Tirana Bank ShA më datë 19.09.2003 (që në dhjetor 2004 u bë 1.254.484 lekë), si dhe kursimet e vitit 2005. Shuma 15.000 euro, e deklaruar si burim në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, është në të vërtetë shuma 1.700.000 lekë, që rrjedh nga depozita në Tirana Bank ShA, e tërhequr më datë 05.10.2005, një ditë para blerjes së apartamentit me sipërfaqe 71 m². Shuma 15.000 euro [1.700.000 lekë], së bashku me shumën 23.000 USD dhe huan në shumën 2.000.000 lekë, është e barabartë me shumën totale të shpenzuar për blerjen e apartamentit. Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë bankare, përcjellë nga Tirana Bank ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 08.03.2019, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit më datë 14.09.2005, krijon depozitë me afat në vlerën 1.700.000 lekë [llogaria nr. {***}], shumë e cila bashkë me interesat bankarë, tërhiqet më datë 05.10.2005, në vlerën 1.712.551 lekë, dhe depozita mbyllet. Data e tërheqjes së kësaj shume korrespondon një ditë përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes

për porositjen e apartamentit objekt shqyrtimi.

15.3. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues konstatoi që subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi si burim krijimi të apartamentit me sipërfaqe 71 m², të ndodhur në Tiranë, ka deklaruar të ardhurat nga pagat, ndërkohë që për krijimin e depozitës 23.000 USD, më datë 05.04.2002, në Intesa San Paolo Bank ShA, dhe depozitës 1.700.000 lekë [ose 15.000 euro] në Tirana Bank ShA, më datë 13.09.2005, kanë shërbyer dhe të ardhurat nga anëtarët e tjerë të familjes M., në kuadër të regjimit të përbashkët familjar. Kjo pasaktësi në deklaram, e pashoqëruar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, nuk përbën shkak për aplikimin e nenit 61, pika 3 e këtij ligji, pasi nuk ndodhemi në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit.

16. Lidhur me *huan prej 2.000.000 lekësh, marrë të tretëve*, Komisioneri Publik pretendon se të ardhurat e ligjshme nga emigracioni, në shumën 29.613 euro, janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në shtetin grek për një familje me 3 anëtarë, për periudhën deri në vitin 2005 [mbështetur në referencat e vendimit (JR) nr. 32/2019 të Kolegjit]; (b) ndryshe nga Komisioni, me konsideratë jurisprudencën²³ e Kolegjit, Komisioneri Publik konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat nga shfrytëzimi i ullinjve, nuk konsiderohet dokumentacion justifikues për të provuar masën e të ardhurave të pretenduara të realizuara, si dhe faktin nëse për to janë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

16.1. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, ka deklaruar: *detyrim për blerjen e apartamentit ndaj vëllait tim I. M., shuma totale e detyrimit: 20.000 euro*, ndërsa në deklaratat periodike të viteve 2006 – 2009, deklararon detyrimin kundrejt të vëllait, të pashlyer ende, në vlerën 2.000.000 lekë. Ky detyrim, po sipas deklaratave periodike të viteve 2010 dhe 2016, është shlyer 1.000.000 lekë në vitin 2010 me të ardhura nga *shitja e 10% të aksioneve të shoqërisë {***} ShA të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit*, dhe në vitin 2016 është shlyer shuma 1.000.000 lekë, e përfituar nga *shitja e automjetit “Autoveturë Mercedes” {***}, në shumën 900.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19 dhjetor 2016, si dhe nga të ardhurat familjare, vjetore.*

16.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Shlyerje tërësisht e detyrimit që rrjedh nga kontrata e huas, marrë vëllait I. M. në shumën 1.000.000 lekë [...]. Burimi i krijimit të shlyerjes së huas: Gjatë vitit 2010 është shlyer shuma prej 1.000.000 lekësh, e cila është siguruar nga shitja e 10% të aksioneve të shoqërisë {***} ShA të personit të lidhur. Ndërsa detyrimi i mbetur, 1.000.000 lekë, është shlyer gjatë vitit 2016, nga të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit “Autoveturë Mercedes” {***}, në shumën 900.000 lekë [...], si dhe nga të ardhurat familjare vjetore.*

Burimi i origjinës së vlerës monetare të huadhënësit, janë të ardhurat familjare të siguruara nga marrëdhëniet e punës, paga si punëmarrës në shtetin grek, pasi nga viti 1992 e aktualisht është rezident në shtetin grek, provuar nga leja e qëndrimit afatgjatë deri në datën 01.04.2020.

16.3. Trupi gjykues konstaton se dhënia e kësaj huaje nuk është formalizuar me një dokument zyrtar, por kjo marrëdhënie detyrimi është konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet deklaratave të pasurisë, dhe nga I. M. nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***}rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2019. Trupi gjykues e konsideron bindës deklarimin e subjektit të rivlerësimit

²³ Shih vendimet (JR) nr. 12/2018 dhe nr. 32/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

duke e konsideruar huan në shumën 2.000.000 lekë, fakt i përmendur nga subjekti i rivlerësimit para fillimit të procesit të rivlerësimit, konkretisht në ILDKPKI, në deklaratat periodike vjetore vijuese dhe në procesverbalin e datës 02.10.2014 “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”.

16.4. Për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të shumës së dhënë hua, në vlerën 2.000.000 lekë, nga *personi tjetër i lidhur*, në zbatim të nenit 32, pika 4²⁴ e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues për të ardhurat e ligjshme të huadhënësit I. M. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, vëllai i tij ka jetuar dhe punuar prej vitit 1996 e në vazhdim, në shtetin grek. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: *Raport i likuidimit të tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë me bazë deklaratën fillestare*, për z. I. M. dhe bashkëshorten e tij S. M., për secilin vit ekonomik/fiskal të periudhës 2001 – 2016, të lëshuara nga Prefektura {***}, Greqi.

16.5. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se, referuar akteve të administruara për të ardhurat e ligjshme të familjes së huadhënësit I. M. nga emigracioni, për periudhën deri në vitin 2005, janë në shumën 29.613 euro, të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në shtetin grek për një familje me 3 anëtarë për periudhën deri në vitin 2005 [mbështetur në referencat e vendimit (JR) nr. 32/2019 të Kolegjit], trupi gjykues konstaton se:

16.5.1. Nga analizimi i dokumentacionit ligjor të administruar për të ardhurat e z. I. M. dhe të bashkëshortes së tij nga punësimi në Greqi, *Raporti i likuidimit të tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë me bazë deklaratën fillestare*, për periudhën nga viti 2001 deri në tetor të vitit 2005, rezulton se këto të ardhura kanë qenë në shumën 37.053 euro, si përlllogaritur në paragrafin 24.9.7. të vendimit të Komisionit, dhe jo në shumën 29.613 euro, si pretenduar nga Komisioneri Publik në ankim, kjo për faktin se në *raportin e likuidimit të tatimit mbi të ardhurat e personave fizikë [...] për vitet 2001 dhe 2002, të ardhurat janë deklaruar në monedhën dhrahmi greke [GRD] dhe jo në euro, si përlllogaritur nga Komisioneri Publik. Ndërsa, sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik se të ardhurat nga emigracioni i huadhënësit I. M. janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në shtetin grek për një familje me tre anëtarë, mbështetur në referencat e vendimit (JR) nr. 32/2019 të Kolegjit, trupi gjykues konstaton se në këtë vendim të Kolegjit, rezulton të jenë arsyetuar shpenzimet e jetesës në Mbretërinë e Bashkuar dhe jo në Greqi. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit që, për të përlllogaritur shpenzimet e jetesës, është mbështetur në të dhënat statistikore nga autoriteti grek i statistikave²⁵, si institucioni përgjegjës në gjenerimin e të dhënave zyrtare për këtë shtet. Rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj për periudhën 2001 deri 30.09.2005, treguan se familja e huadhënësit I. M. ka pasur mundësi financiare jo vetëm të mbulojë shpenzimet jetike, por edhe të kursejë shumën 5.417 euro [konvertuar në 679.551 lekë].*

16.6. Lidhur me të ardhurat e ligjshme të z. I. M., për të justifikuar këtë huadhënie, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit shpjegon se, përveç të ardhurave nga punësimi në shtetin grek, z. I. M. ka përfituar nga ligji nr.7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, tokë bujqësore, *ullishte*, ndodhur në Bashkinë Patos [me AMTP nr. {***}], e ndarë në dy parcela, me 100 rrënjë ullinj. Sipas formularit nr. {***}, datë 08.04.1993, që disponon arkiva e DAMT-së të Këshillit të Qarkut Fier, z. I. M. figuron përfitues i tokës ullishte me 100 rrënjë ullinj, rrënjë të reja.

16.7. Për përlllogaritjen e të ardhurave nga toka ullishte e z. I. M. , subjekti i rivlerësimit,

²⁴ Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016: “4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

²⁵ <http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>

ashtu si për të ardhurat e z. H. M., depozitoi *Raport vlerësimi për të ardhurat nga ullahtat e I. M.*, përgatitur po nga eksperte e licencuar L. B., administratore e {***} ShPK, datë 10.12.2019. Sipas këtij raporti vlerësimi, vlera e të ardhurave të krijuara nga prodhimi i ullirit, për periudhën 1994 – 2005, është 4.157.550 lekë. Përveç dokumentacionit për përfitimin e *tokës bujqësore, ullahte* me 100 rrënjë ullinj, subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet, ka depozituar vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Patos që provojnë se I. M. ka shlyer taksën vendore deri në fund të vitit 2021, si dhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që këto prona nuk kanë qenë objekt kontestimi në gjykatë.

16.8. Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, ashtu si për të ardhurat e shtetasit H. M. depozitoi: i) deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 16.05.2021, të shtetasit M. Rr., në lidhje me të ardhurat nga ullahta e z. I. M., shoqëruar me deklaratën e thjeshtë të depozituar gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe fletë nga blloku i shënimeve të tij; ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep./kol., datë 15.05.2021, të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë {***} ShPK, z. T. Sh., për prodhimin e ullahtave të z. I. M., shoqëruar me deklaratën e thjeshtë dhe fletëhyrjet e lëshuara nga data 07.11.2003 deri më dhjetor 2006, si dhe ekstraktin historik të shoqërisë, i nënshkruar elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

16.9. Duke ndjekur të njëjtin arsyetim si për të ardhurat nga shfrytëzimi i ullahtave të shtetasit H. M., trupi gjykues i Kolegjit vendosi të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet ekonomik. Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare të personit tjetër të lidhur I. M., për të verifikuar mundësinë financiare të tij për dhënien e huas 2.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit, në shtator të vitit 2005. Rezultatet e analizës financiare treguan mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të vëllait të subjektit të rivlerësimit I. M. për dhënien e kësaj huaje, të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 71 m², blerë nga subjekti i rivlerësimit në tetor 2005.

16.10. Në përmbledhje të gjithë sa arsyetuar më sipër, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 71 m², të ndodhur në rr. {***}, Tiranë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe anëtarët e tjerë të familjes rezultojnë me mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e depozitave bankare, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka pretenduar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat nga shitja e apartamentit në emër të z. A. M. më 10.09.2005, në vlerën 2.000.000 lekë, nëse këto të ardhura do të përfshihen në analizën financiare në kuadër të regjimit të përbashkët familjar, do të rritej teprica pozitive e rezultuar. Gjithashtu me mjaftueshmëri të burimeve financiare rezulton dhe i vëllai i subjektit të rivlerësimit I. M., në cilësinë e huadhënësit, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për dhënien e huas prej 2.000.000 lekësh në shtator 2005, që ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie.

17. *Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 62,65 m², ndodhur në Patos, Fier, lidhur me mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit të kësaj pasurie në bashkëpronësi me të afërmit e saj, në deklaratën e pasurisë vetting, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ta deklarojë këtë pasuri bazuar në parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë. Në analizë të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, trupi gjykues konstaton:*

17.1. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se nga të gjitha rrethanat e faktit, rezulton se kemi të bëjmë me një harresë të paqëllimshme, e cila nuk ka sjellë fshehje të pasurisë, për aq kohë sa evidentohet në regjistrat hipotekorë, si dhe origjina e kësaj pasurie është nga privatizimi. Duke qenë se ky apartament është në pronësi të përbashkët të subjektit

dhe të familjes së tij, nuk evidentohen të dhëna që të lindin dyshime për fshehje apo veprime korruptive në blerje të kësaj pasurie. Pavarësisht kësaj, Komisioni vlerëson se mbetet fakt që subjekti nuk e ka deklaruar këtë bashkëpronësi në deklaratën *vetting*, duke e vënë subjektin në kushtet e pasaktësisë në deklaram, por që nuk ka pasur për qëllim fshehjen e pasurisë, duke mos përbërë në këtë mënyrë shkak për shkarkimin e subjektit.

17.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.03.2019, konfirmon pasurinë nr. {***}, volumi {***}, faqe {***}, ZK {***} Patos, e llojit apartament me sipërfaqe 62,65 m², në emër të H. H. M., D. A. M., I. H. M., Irena. H. Maneku. Referuar dokumentacionit të përcjellë me këtë shkresë, kjo pasuri është përfituar nëpërmjet *kontratës për privatizimin e banesës*, datë 25.05.1993, të lidhur mes NK Banesa dhe qiramarrësit H. M. (Sh.)²⁶ për privatizimin e banesës nr. {***}, rruga {***}, në vlerën 6.777 lekë. Familja M., më datë 01.12.1992, sipas certifikatës bashkëlidhur praktikës së privatizimit të banesës, ka qenë e përbërë nga 5 anëtarë: H., D., I., Irena dhe A. M.

17.3. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.11.2019, sqaron se, pas verifikimit të kryer në sistemin digjital të pasurive të paluajtshme, rezulton se në emër të Irena. H. Maneku. (Sh.), së bashku me 3 bashkëpronarë, H. M., D. M., I. M., figuron e regjistruar pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, zk. {***}, e llojit apartament, me sipërfaqe 62,7 m², pajisur me certifikatë pronësie, datë 22.04.2010. Referuar dokumentit “Kartelë e pasurisë së paluajtshme”, ky apartament rezulton i regjistruar më datë 22.04.2010, në emër të 4 bashkëpronarëve: H., D., I. dhe Irena Maneku, Fier, Patos.

17.4. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting*, të pjesës takuese 1/4 të këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision dhe në parashtrimet në Kolegj, sqaroi se kjo vjen për shkak të një harrese njerëzore, mënyrës së fitimit të pronësisë përmes privatizimit, mosvënies në diskutim të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit për krijimin e kësaj pasurie, mungesës së dashjes për të mos ta deklaruar, mungesës së posedimit faktik të kësaj pasurie, vlerës së papërfillshme të saj, ngarkesës në punë, angazhimeve familjare, shkaqeve shëndetësore, urgjencës për të mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për *vetting*. Mungon qëllimi, sipas subjektit të rivlerësimit, për të mos deklaruar apo për ta fshehur këtë pasuri lehtësisht të gjetshme dhe të gjurmueshme. Duke qenë se kjo pasuri vjen si rezultat i privatizimit, bashkëpronësia rrjedh nga ligji dhe subjekti nuk ka kontribuar në krijimin e saj.

17.5. Në mbështetje të kësaj situatë faktike, trupi gjyqësor vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ka pasaktësi lidhur me mosdeklarimin e pjesës takuese mbi këtë pasuri, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Nisur nga rrethanat e faktit, si dhe mënyra e përfitimit të kësaj banese, nëpërmjet privatizimit nga babai i subjektit të rivlerësimit, si dhe mjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, kjo pasaktësi nuk mund të ngrihet në atë nivel sa të kualifikohet sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës apo për pamjaftueshmëri në deklaram, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

18. Për pasurinë “dy garazhe”, me sipërfaqe 14 m² secili, ndodhur në rr. {***}, Tiranë, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, kthimin e huas në shumën 1.000.000 lekë, në vitin 2011, dhe posedimin e *cash-it* në këtë vit dhe, si rrjedhojë, nuk justifikohet me të ardhura nga burime të ligjshme shuma e depozituar pranë Raiffeisen Bank në datë 26.11.2013, përdorur për blerjen e

²⁶ Në certifikatën familjare të lëshuar nga Njësia Administrative Patos, datë 05.11.2019 [nr. {***}], shënohet: “[...] Irena ka ndryshuar mbiemrin me proc.verb. Patos nr. {***}, dt. 12.03.2004, nga M. në Sh., me proc.verb. nr. {***}, dt. 28.07.2004, ndryshon mbiemrin nga Sh. në M.”.

dy garazheve. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj. Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, trupi gjykues konstaton se:

18.1. Komisioni, për këto pasuri, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarinë e gjendjes *cash* ndër vite, pasi nuk ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë (e cila ka burim të ligjshëm), por ndërkohë në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar saktësisht se shuma 1.000.000 lekë ka shërbyer si burim për blerjen e garazheve, fakt që provohet dhe me depozitim të shumës 1.300.000 lekë në Raiffeisen Bank. Mosdeklarimi i kthimit të shumës 1.000.000 lekë, është një pasaktësi e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, por jo në deklaratën e pasurisë *vetting*, për rrjedhojë, Komisioni, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe mbështetur në analizën e mësipërme, përfshiu këtë shumë në analizën financiare të vitit 2013, duke e kthyer gjendjen e subjektit për këtë vit, pozitive.

18.2. Nga analizimi i akteve në dosje, rezulton që këto pasuri të jenë përfituar me *kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2013*, të nënshkruar mes palës shitëse Raiffeisen Bank ShA dhe blerësit S. Gj. Sipas kushteve të parashikuara në këtë kontratë, pasuritë e paluajtshme shiten për çmimin e përcaktuar përmes një procesi ofertimi në masën 650.000 lekë secili, dhe kontrata ka një çmim kompleksiv prej 1.300.000 lekësh. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi: *dy garazhe me sipërfaqe 14 m², secili, adresa: rruga {***}, Tiranë, blerë sipas kontratës së shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2013, nga Raiffeisen Bank ShA, çmimi i blerjes 1.300.000 lekë. Regjistruar në Z.R.P.P Tiranë, certifikatë për vërtetim pronësie, datë 18.12.2013. Burimi i krijimit, shuma prej 1.000.000 lekë janë të ardhura të realizuara nga shitja e 10% të aksioneve të {***} ShA (shumë të cilën e kemi pasur në cash, dhe pjesa tjetër shuma prej 300.000 lekësh, kursimet nga paga). Pjesa takuese: 100 %.*

18.3. Me shkresën nr. {***} prot., datë 20.04.2022, të ILDKPKI-së, me lëndë “Kthim përgjigje”, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës në Kolegj, përcillet deklarata e interesave privatë të vitit 2013. Trupi gjykues konstaton se kjo deklaratë ka ndryshime krahasuar me atë të përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision, bashkëlidhur raportit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Konkretisht, në deklaratën e dërguar nga ILDKPKI-ja në Komision, deklarata periodike e vitit 2013 rezulton të jetë depozituar në të njëjtën datë me deklaratën periodike të vitit 2011 [më 16.03.2012]. Ndërkohë që në deklaratën e vitit 2013, të sjellë nga subjekti me parashtrimet e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja me shkresën e sipërcituar [dorëzuar më 19.03.2014], në faqen 10, nga personi i lidhur rezulton të jetë deklaruar: *Shtim pasurie – Garazh me sip. 28 m² në favor të S. Gj., ndodhur në rruga {***}, Tiranë, e blerë nga Raiffeisen Bank, çmimi blerjes 1.300.000 lekë [...]. Burimi i krijimit, pjesërisht shuma 1.000.000 lekë të ardhura, e siguruar nga shitja e aksioneve të lojërave të fatit (shumë të cilën e kemi pasur në qarkullim) dhe pjesa tjetër 300.000 lekë nga kursimet e të ardhurave nga pagat. Pjesa takuese: 100 %.*

18.4. Nga analizimi i akteve, rezulton se nëpërmjet *deklaratës për shitje aksionesh nr. {***}, datë 30.08.2006*, drejtori ekzekutiv i shoqërisë, z. Sh. H., deklaroi se më datë 30.08.2006, S. Gj. bleu nga firma 10% të aksioneve, në vlerën 3.300.000 lekë, duke përcaktuar se nga data 01.09.2006 e në vazhdim, z. Gj. është aksioner me të drejta dhe detyra si të gjithë aksionerët e tjerë të shoqërisë. Nëpërmjet *kontratës për shitje aksionesh të shoqërisë {***} ShA, nr. {***} rep., {***} kol., datë 21.03.2009, z. S. Gj. i shet 10% të aksioneve të tij shoqërisë, në vlerën 2.000.000 lekë, përfaqësuar në cilësinë e blerësit nga Sh. H.*

18.5. Shitja e aksioneve në shoqërinë {***} ShA, në shumën 2.000.000 lekë, deklarohet nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë 2009. Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi, *detyrim kundrejt vëllait i përdorur për blerjen e*

*banesës, në shumën 2.000.000 lekë, ku gjatë vitit 2010 është shlyer shuma prej 1.000.000 lekësh, e cila është siguruar nga shitja e 10% të aksioneve. Ndërsa personi i lidhur, bashkëshorti, deklaron: ndryshim në depozitë, tërheqje totale e depozitës në Bankën Popullore, e siguruar nga shitja e 10% të aksioneve të përdorura, 1.000.000 lekë për shlyerjen e detyrimit ndaj vëllait dhe 1.000.000 lekë të dhëna hua. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit sqaron se bashkëshorti këtë shumë ia ka dhënë hua vajzës së tij, A. Gj., në muajin korrik-gusht 2010, për të vizituar të afërm të saj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për të parë mundësinë e aplikimit për studime. Në janar të vitit 2011, kjo shumë i është kthyer bashkëshortit, pasi e bija nuk e përdori për qëllimin e kërkuar. Për këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.12.2019, të znj. A. Gj., e cila konfirmon të njëjtin fakt që parashtron subjekti i rivlerësimit, duke cituar ndër të tjera se për shkak të marrëdhënieve familjare të posaçme, për këtë hua nuk është bërë kontratë huaje formale.*

18.6. Në vijim të parashtrimeve të tij, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk është interesuar për momentin e kthimit të shumës dhe pagimin e çmimit të garazheve, për shkak të mosndërhyrjes në marrëdhënien e babait me të bijën, duke mos dashur të reflektonte as në dukje interes ndaj shumës së dhënë hua për qëllime studimi, vajzës së bashkëshortit. Bashkëshorti, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk e ka pasur të qartë plotësimin e deklaratave periodike, duke sjellë dhe pasaktësi në deklarin e kursimeve *cash* ndër vite. Subjekti i rivlerësimit sqaron gjithashtu se, nga bashkëshorti, i është komunikuar që mosdeklarimi i huas ka ardhur për faktin se huaja është kthyer përpara dorëzimit të deklaratës periodike, duke marrë të mirëqenë faktin që burimi i kësaj huaje është i ligjshëm dhe i krijuar me të ardhura të ligjshme. Për këtë fakt, Komisioneri Publik, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk ka ngritur pretendim në lidhje me burimin e ligjshëm të blerjes së kuotave të shoqërisë {***} ShA dhe të shitjes së tyre.

Subjekti i rivlerësimit në vijim parashtroi se shumën 1.000.000 lekë, bashkëshorti nuk e ka futur në depozitë pas vitit 2010 kur u tërhoq, dhe as ta ketë investuar në blerjen e ndonjë pasurie. Kjo parregullsi në deklarin e bashkëshortit, ka ardhur për arsye se kishte menduar që, për sa kohë e kishte deklaruar të tërhequr nga banka dhe dhënë hua, fakti i kthimit të huas nuk ndikonte në deklarin, pasi ato ishin gjendje *cash*, për më tepër që kjo shumë i ishte dhënë hua vajzës, hua e paformalizuar për shkak të marrëdhënies së posaçme, dhe që sipas nenit 233, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile, përbën një shkak ligjor që legjitimon provimin e marrëdhënies juridike edhe me deklarime. Sipas subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, ka vetëm parregullsi në deklarin e gjendjes *cash*, pasi është konsideruar e deklaruar hua në vitin 2010, dhe e kthyer nga huamarrësi në vitin 2011. Kjo mënyrë të deklaruarit ka qenë konstante, sqaron subjekti, dhe vërteton mungesën e pasaktësisë apo të pamjaftueshmërisë, si dhe mungesën e qëllimit për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë.

18.7. Në mbështetje të situatës faktike si më sipër, pavarësisht se shuma prej 1.000.000 lekësh nuk u deklarua gjendje në *cash* në deklaratat e interesave privatë të viteve 2011 dhe 2012, në kushtet kur i lidhur në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010, deklaron: *tërheqje totale e depozitës në Bankën Popullore, e siguruar nga shitja e 10% të aksioneve të përdorura, 1.000.000 lekë për shlyerjen e detyrimit ndaj vëllait dhe 1.000.000 lekë të dhëna hua, dhe në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2013, ka deklaruar si burim krijimi pikërisht shumën 1.000.000 lekë të ardhura të siguruara nga shitja e aksioneve të lojërave të fatit (shumë të cilën e kemi pasur në qarkullim) dhe pjesën tjetër 300.000 lekë nga kursimet e të ardhurave nga pagat, duke bërë të njëjtin deklarin për burimin e dy garazheve edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues e përfshiu këtë në analizën financiare të kryer në Kolegj. Sa i përket burimit të dytë, prej 300.000 lekësh të ardhura nga pagat, analiza financiare e kryer në*

Kolegj tregoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin mundësi financiare për të kursyer këtë shumë gjatë periudhës 01.01.2013 deri më 25.11.2013. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, pas provave të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna në seancën gjyqësore publike të datës 26.05.2022, rezultuan me mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre.

19. Për *pasurinë autoveturë “Mercedes Benz”, modeli B 180*, Komisioneri Publik pretendon se: i) analiza financiare për të vlerësuar mjaftueshmërinë e të ardhurave nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit për të mbuluar blerjen e pasurisë dhe shpenzimet, duhej të shtrihej deri në datën 28.06.2014, që përkon me datën e pagesës së zhdoganimit të automjetit; ii) përfundimi i Komisionit se babai i subjektit ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 5.000 euro, nuk është i bazuar në gjendjen faktike të provave, pasi Komisioni ka përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme të personit tjetër të lidhur, edhe shumën prej 5.841.438 lekësh, në zërin të ardhura nga ullahta për periudhën 2006 – 28.06.2014, të cilat, si arsytuar më sipër, nuk rezultojnë në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës; iii) huaja nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë, referuar nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për huan dhe, rrjedhimisht, rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

19.1. Për burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në konkluzionin se, nga analiza financiare, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 5.000 euro, hua e cila rezulton e shlyer në vitin 2015, bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015. Nga analiza financiare, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kësaj huaje.

19.2. Nga analizimi i deklarimeve periodike në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur, rezultojnë të kenë deklaruar:

19.2.1. Në deklaratën e interesave privatë 2014, bashkëshorti i subjektit deklaroi: *autoveturë Mercedes, modeli B 180 CDI, blerë në qershor 2014. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga si dhe huaja prej 5.000 eurosh, marrë hua nga i paralinduri i bashkëshortes [babai]. Në vlerën: 6.557 euro. Pjesa takuese: 100%.*

19.2.2. Në deklaratën e interesave privatë 2015, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Shlyerje totale e detyrimit ndaj të paralindurit (babai H. M.), në shumën 5.000 euro, me kontratë huaje përdorur për blerjen e autoveturës në qershor 2014. Burimi: Krijuar nga të ardhurat familjare vjetore.*

19.2.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshorti i subjektit deklaroi: *Autoveturë “Mercedes Benz” modeli B 180, viti i prodhimit 2010, CDI, datë e blerjes 20.06.2014, çmimi i blerjes 6.557 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga, si dhe huaja prej 5.000 eurosh, marrë nga i paralinduri i bashkëshortes (babai), shlyer totalisht gjatë vitit 2015, nga të ardhurat familjare vjetore. Pjesa takuese: 100%.*

19.3. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. {***} prot., datë 12.11.2019, rezulton se nga verifikimet e bëra, Irena Maneku nuk ka dhe nuk ka pasur mjete të regjistruara, ndërsa shtetasi S. Gj. ka pasur të regjistruar mjetin me targë {***}, me targë aktuale {***} dhe ka aktualisht në pronësi mjetin me targë {***}, i tipit Daimler Chrysler, B 180 CDI, që sipas akteve të dosjes së mjetit, është blerë në Itali, më datë 20.06.2014, në vlerën 6.557 euro, nga shitësi {***} s.a.s di L. B. Detyrimi doganor në vlerën 187.757 lekë për këtë automjet, është paguar më datë 28.06.2014.

19.4. Komisioneri Publik, nisur nga fakti që detyrimi doganor është paguar më datë 28.06.2014, pretendon që edhe analiza e Komisionit duhej të shtrihet deri në këtë datë. Analiza financiare e kryer në Komision [paragrafi 32.3, faqe 19 e vendimit], rezulton të jetë shtrirë deri më datë 20.06.2014, që përkon me pagesën e faturës të blerjes së automjetit. Nëse do të ndiqnim argumentin e Komisionerit Publik, për shtrirjen e analizës me plus 8 ditë nga ajo e Komisionit, duke përfshirë në këtë analizë dhe pagesën e detyrimit tatimor, në kushtet kur të ardhurat nuk do të kishin ndryshim, duke përfshirë detyrimin doganor, atëherë analiza do të tregonte një diferencë negative prej vetëm -11.383 lekësh, e cila nuk është domethënëse për ta konsideruar pamjaftueshmëri.

19.5. Si burim krijimi të kësaj pasurie, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron edhe huan e marrë nga babai i tij, në shumën 5.000 euro, fakt i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë 2014, rubrika “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, hua marrë nga i paralinduri, babai H. M., me kontratë huaje përdorur për blerjen e autoveturës në qershor 2014, pa interes, pa afat kthimi, në vlerën 5.000 euro. Ndërsa personi i lidhur e deklaron këtë pasuri: *Autoveturë Mercedes, modeli B 180 CDI, në emër të bashkëshortit, blerë në qershor 2014. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga, si dhe huaja prej 5.000 eurosh, marrë hua nga i paralinduri i bashkëshortes [babai].* Shlyerja e plotë e këtij detyrimi është deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2015.

19.6. Kjo marrëdhënie detyrimi është formalizuar me kontratë huadhënie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2014, e nënshkruar mes huadhënësit H. M. dhe huamarrësit Irena Gjoka, pa afat kthimi dhe pa interes. Në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën për të provuar të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur, babait, për dhënien e shumës 5.000 euro. Për të provuar aftësinë financiare të babait për dhënien hua të kësaj shume, subjekti i rivlerësimit ka depozituar disa kontrata shitblerje²⁷ pasurie të paluajtshme, konkretisht truell ndodhur në {***}, Fier, si dhe vërtetime²⁸ lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Fier, nëpërmjet të cilave vërtetohet pensioni i z. H. M. për periudhën nga 06.03.1995, deri në vitin 2019.

19.7. Për të provuar aftësinë huadhënëse të babait të subjektit, Komisioni kreu analizën financiare të periudhës 2006 deri më 13.06.2014, që korrespondon me ditën e dhënies së huas. Kjo analizë [shih paragrafin 32.4.2 të vendimit] tregoi se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura për dhënien e huas në vlerën 5.000 euro, në qershor të vitit 2014. Në kushtet kur Komisioneri Publik ka kundërshtuar përfshirjen e të ardhurave nga shfrytëzimi i ullishtës, me arsyetimin se këto të ardhura nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues, mbi bazë të provave të paraqitura dhe arsyetimit të bërë në paragrafët 13.18 - 13.20 të këtij vendimi, i ka përfshirë në përlllogaritje të ardhurat nga shfrytëzimi i ullishtave të huadhënësit H. M..

19.8. Në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, babai i saj, H. M., cilësohet dy herë si *person tjetër i lidhur*, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konkretisht në vitin 2008 për dhënien hua të shumës 1.500.000 lekë S. Gj. [trajtuar në paragrafin 20.3 e nënparagrafët e tij në këtë vendim] dhe për kontratën e huadhënies nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2014, për dhënien hua subjektit të rivlerësimit, të shumës 5.000 euro, si burim për krijimin e autoveturës “Mercedes Benz”, modeli B 180. Për të provuar ligjshmërinë e huave të dhëna nga babai, subjekti i rivlerësimit depoziton në Komision dokumentacionin, nga ku rezulton se në vitin 2008, sipas kontratës për shitblerje pasurie të

²⁷ 1. Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, truell, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2006, për shitjen e truallit me sipërfaqe 682 m², në vlerën 150.000 lekë; 2. kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2008, për shitjen e truallit me sipërfaqe 1507 m², në vlerën 1.478.367 lekë; 3. kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2009, për shitjen e truallit me sipërfaqe 540 m², kundrejt shumës 529.740 lekë.

²⁸ Vërtetim nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot., datë 03.12.2019.

paluajtshme, truall, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2006; dhe ii) kontratës për shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2008, babai i subjektit ka përfituar shumën 1.628.367 lekë, të mjaftueshme për dhënien e huas në vitin 2008, pretenduar të kthyer brenda vitit dhe, për rrjedhojë, të mjaftueshme për dhënien e huas 5.000 euro në vitin 2014, për blerjen e automjetit. Për më tepër, kur në vitin 2009, babai i subjektit ka përfituar shumën 529.740 lekë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.01.2009, thuajse sa shuma e dhënë hua.

19.9. Në përfundim, për këtë pasuri, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, dhe personi i lidhur justifikojnë krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme. Po kështu, babai i subjektit të rivlerësimit, z. H. M., ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, për dhënien hua subjektit të rivlerësimit të shumës 5.000 euro në vitin 2014, që ka shërbyer si burim për blerjen e këtij automjeti.

20. Komisioneri Publik në ankim ka ngritur dhe pretendime për *çështje të tjera*, të cilat lidhen kryesisht me të ardhurat apo interesat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të cilat trupi gjykues i arsyeton si në vijim.

20.1. Sa i përket *transaksionit 12.000 euro* në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në bankën Societe Generale Albania ShA, në vlerësim të Komisionerit Publik, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore që konsiderohen si provë gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të të kenë deklaruar kursime në *cash* në vitet 2005 dhe 2006. Lidhur me këtë pretendim, nga analizimi i akteve të dosjes, trupi gjykues konstaton:

20.1.1. Nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 15.03.2019, banka Societe Generale Albania ShA informon Komisionin mbi llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në lekë/euro/dollarë amerikanë të shtetasit S. Gj. pranë kësaj banke. Në llogarinë rrjedhëse në monedhën euro, me numër {***}, më datë 03.07.2007, rezulton që, me xhirim të brendshëm, të jetë transferuar shuma 12.000 euro në llogari të shtetasit S. Gj. nga llogaria e z. G. B.

20.1.2. Në përgjigjen e dhënë pyetësorit nr. {***}, datë 31.10.2019, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se z. G. B. ka qenë punonjës i kësaj banke, dega Fier, nga data 15.07.2005 deri më 15.12.2009 dhe, për shkak të miqësisë dhe marrëdhënies së besimit, bashkëshorti ia ka besuar që këtë shumë ta depozitonte ai në llogarinë e tij. Në mbështetje të sqarimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar këto akte shkresore: i) vërtetim nr. {***} prot., datë 06.11.2019, të Bankës OTP Albania ShA, mbi punësimin pranë kësaj banke të z. G. B.; ii) deklarata noteriale e këtij të fundit, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.11.2019; iii) lëvizja e llogarive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë kësaj banke.

20.1.3. Në parashtrimet para Kolegjit, lidhur me shumën 12.000 euro që ka shërbyer, sipas subjektit të rivlerësimit, si burim për krijimin e pasurisë autoveturë Mercedes Benz, modeli ML 270²⁹, subjekti sqaroi se kjo shumë e ka burimin nga të ardhurat e krijuara e të kursyera ndër vite, nga qiraja dhe shitja e pasurive të paluajtshme e të luajtshme të bashkëshortit. Kursimet janë mbajtur *cash* nga bashkëshorti, por nuk janë deklaruar prej tij, për shkak të pakujdesisë dhe moskuptimit të drejtë të ligjit, duke shpjeguar se ishte viti i parë i deklarimit të personit të lidhur. Subjekti i rivlerësimit sqaroi gjithashtu se, nga llogaritë e bashkëshortit në Tirana Bank ShA, evidentohen tërheqje të kryera prej tij: i) më datë 30.06.2006, tërhequr shuma 9.140 USD, përdorur për depozitën në vitin pasardhës; ii) më datë 06.05.2005, tërhequr shuma 18.000 USD; iii) më datë 30.06.2006, tërhequr shuma 30.000 USD, prej të cilave 25.000 USD janë shpenzuar në vitin 2006, kurse 5.000 USD janë mbajtur rezervë duke

²⁹ Pasuri e tjetërsuar në momentin e depozitimit të deklaratës së pasurisë vetting, në të cilën janë deklaruar të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie.

u depozituar në vitin 2007 në bankë, tërhequr më pas për të blerë automjetin në shumën 15.000 euro. Shuma 9.140 USD dhe 5.000 USD, në total 14.140 USD, janë një shumë e përafërt me depozitën në vlerën 12.000 euro. Në vijim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit sqaroi se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007³⁰, kur ka deklaruar automjetin “Mercedez Benz”, modeli ML 270, si burim krijimi, janë deklaruar edhe vlerat monetare të depozituara në bankë, tërhequr nga llogaritë në USD, duke bërë të njëjtin deklaram me atë gjatë hetimit administrativ.

20.1.4. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo depozitë ka si burim krijimi kursimet nga të ardhurat si vijojnë: i) të ardhurat nga qiratë e lokalit, ndodhur në Fier, për periudhën 1995 - 2001; ii) të ardhurat nga shitja e lokalit, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2002³¹, në shumën 2.000.000 lekë; iii) të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit, me kontratën e shitblerjes nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 10.09.2003, në shumën 1.200.000 lekë.

20.1.5. Në mbështetje të sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se likuiditetet në vlerën 12.000 euro janë krijuar nga bashkëshorti, z. S. Gj., para regjimit martesor³² me subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka dhe, në rrethanat konkrete, nuk mund të përfshihen në procesin e rivlerësimit të kësaj të fundit.

20.2. Mbi *transaksionin 10.000 euro* në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Tirana Bank ShA, Komisioni në vendim, ka vlerësuar *se nuk ka paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë pasuri. Kjo depozitë e ka origjinën e saj gjatë kohës së regjimit të parë martesor të zotit Gj.* Komisioneri Publik, në ankim, vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbeten thjesht në nivel deklarativ. Trupi gjykues në lidhje me këtë pretendim, konstaton:

20.2.1. Nga aktet e depozituara në dosjen gjyqësore gjatë hetimit administrativ, konkretisht nga lëvizja e llogarive, përcjellë nga Tirana Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.11.2019, nga lëvizja e llogarisë bankare nr. {***} në euro e z. S. Gj., rezulton që më datë 12.03.2002, të jetë hapur një depozitë me afat, ku është depozituar shuma 10.000 euro nga znj. Irena Maneku, me përshkrimin: “Dep-depoz.në Arkë Dep for open new deal DIM from Irena Maneku”.

20.2.2. Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit vënien në dispozicion të dokumentacionit provues mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave për depozitim në kësaj shume. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se, në datën 12.03.2002, z. Gj. ka çelur depozitë me afat në Tirana Bank ShA, me nr. llogarie {***}, në monedhën euro, në të njëjtën bankë dhe pranë së njëjtës degë. Po në datën e çeljes (datë 12.03.2002), është depozituar në *cash* shuma 10.000 euro, me përshkrimin “Dep. për hapjen e një depozite me afat, nga Irena Maneku”, shumë e cila ka kaluar në depozitë me afat në emër të tij. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se titullar i vetëm i kësaj llogarie është z. Gj., dhe subjekti

³⁰ Në deklaratën periodike të vitit 2007, personi i lidhur ka deklaruar: “Shtim pasurie, blerje e automjetit tip Benz-270, në shumën 15.000 euro. Blerja e së cilës është bërë nga lekët e marra nga shitja e mjetit Benz 190, si dhe lekët e depozituara në bankë, të tërhequra nga llogaria në USD (2006), si dhe kursime të vitit 2007. Po në deklaratën e këtij viti, deklaroi pakësim pasurie nga shitja e autoveturës tip Benz 190, blerë 6.000 USD, shitur në shumën 4000 USD.

³¹ Me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2002, z. S. Gj. i shet znj. A. R., sipërfaqe truall prej 150 m², si dhe një objekt me 2 kate, të ndodhur mbi këtë sipërfaqe truall, në vlerën 2.000.000 lekë, e paguar plotësisht para redaktimit të kësaj kontrate jashtë zyrës së noterisë.

³² Certifikata e martesës së z. S. Gj. me znj. Irena Maneku daton më 25.10.2006.

nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë lidhje me këtë veprim bankar, si dhe nuk ka pasur në pronësi asnjë pjesë të shumës. Për sa është bërë me dije nga bashkëshorti, burimi i depozitës së kësaj shume rrjedh nga llogaria rrjedhëse që ai ka pasur në të njëjtën bankë në monedhën euro, me nr. {***}, në shumën 54.786 euro, që kanë si burim të ardhura të përfituara nga qiradhënia e lokalit dhe shitja e kësaj pasurie. Më datë 05.03.2002, nga kjo llogaria rrjedhëse është tërhequr shuma prej 10.000 eurosh, dhe më datë 12.03.2002 [6 (gjashtë) ditë më pas], kjo shumë është depozituar prej tij në llogarinë depozitë me afat të hapur në të njëjtën bankë, dhe pranë së njëjtës degë. I vetmi hamendësim, sipas subjektit, se përse rezulton si depozituese e shumës 10.000 euro, mund të jetë se veprimet janë kryer në Degën Fier, njiheshin në komunitet dhe ndoshta mund të ketë shoqëruar z. Gj. pranë sportelit të bankës.

20.2.3. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision, shkresën nr. {***} prot., datë 10.12.2019, të Tirana Bank ShA, sipas së cilës: *depozitimi në llogarinë e S. Gj. në datë 12.03.2002, është kryer nga klientja, znj. Irena Maneku, si kreditim dhe depozitim nga palë të treta. Klientja Irena Maneku nuk rezulton të jetë si person i përbashkët në këtë llogari, por depozita me afat e vendosur në llogarinë tuaj dhe veprimet e mëtejshme, janë kryer nga ju personalisht, bazuar edhe në specimenin tuaj të certifikata e depozitës me afat. Veprimet e kreditimit nga të tretët në llogarinë e klientit nuk janë të ndaluara dhe banka nuk i pengon, por as nuk ndërhyjnë në marrëdhëniet e klientit me të tretët.* Sipas sqarimit në shkresën e sipërcituar, komenti “Open New Deal from Manekaj Irena”, i referohet transaksionit të depozitimit të fondeve në llogarinë e shtetasit S. Gj., nga klientja Irena Maneku, veprim që rezulton të jetë njohur nga S. Gj., pasi jo vetëm janë përfituar interesat nga depozita, por është kryer edhe rinovimi i kësaj depozite në llogarinë e tij bankare. Për shkak se afati i ruajtjes³³ së dokumentacionit është 10 vjet, banka informon se e ka të pamundur ofrimin e dokumentacionit të kërkuar.

20.2.4. Sipas subjektit të rivlerësimit, me parashtrimet në Kolegj, Komisioneri Publik nuk ka dhënë asnjë argument apo pretendim në lidhje me këtë transaksion që të lidhet me deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Objekti i procesit të rivlerësimit janë vetëm pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, së bashku me burimin e tyre. Sipas subjektit, për sa kohë ky transaksion nuk ndikon në analizën financiare, si dhe nuk rezulton të jetë pjesë e deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk mund të përdoret nga Komisioneri Publik si shkak ankimi dhe të thuhet se deklaratimet e subjektit janë në nivel deklarativ, pasi është e qartë që deklarimi do të jetë në nivel deklarativ, pasi nuk ka çfarë të provohet, por thjesht është sqaruar një transaksion bankar. Referuar dokumenteve bankare të administruara në Komision, evidentohet se titullari i vetëm i llogarisë është bashkëshorti S. Gj. Me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit depoziton dhe shkresën nr. {***} prot., datë 17.09.2021, të Tirana Bank ShA, drejtuar z. S. Gj., me të cilën konfirmohet se më datë 05.03.2002, nga llogaria e tij nr. {***}, është tërhequr shuma 10.000 euro dhe z. Gj. është i vetmi titullar i llogarisë {***} në euro, ku më 12.03.2002, është depozituar e njëjta vlerë monetare, pra 10.000 euro, e cila në të njëjtën datë është vendosur depozitë me afat.

³³ *Sipas rregullores për arkivimin në Tirana Banka ShA, afati i ruajtjes së dokumentacionit është 10 vjet. Kjo rregullore është e bazuar, por jo e kufizuar, në afatet e ruajtjes së të dhënave sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” dhe legjislacionit përkatës në fuqi.*

20.2.5. Në lidhje me këtë çështje, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka qenë bindës në shpjegimet e dhëna si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu dhe në parashtrimet para Kolegjit, sa i përket kësaj depozite, e cila është krijuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit [më 12.03.2002] para regjimit martesor, ka qëndruar në një llogari bankare që i përket vetëm z. S. Gj., dhe që nuk ka një ndikim financiar në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

20.3. *Lidhur me huatë e dhëna nga bashkëshorti* i subjektit të rivlerësimit në vitet 2008 dhe 2012, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar as mënyrat e marrjes së shumave nga bashkëshorti S. Gj. te huadhënësit H. M. e K. M., dhe as kthimin e këtyre shumave huamarrësve, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të këtyre marrëdhënieve, përkundër detyrimit që ligji i njeh. Deklaratat noteriale të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, datojnë pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit, mbeten në nivelin deklarativ, nuk mund të konfirmojnë të vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to, kanë ndodhur realisht.

20.3.1. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka arritur në përfundimin se z. H. M. dhe z. K. M. kanë pasur të ardhura të mjaftueshme monetare për financimin e z. S. Gj., në dhënien hua të shumave 16.000 USD dhe 34.500 USD z. A. Z., përkatësisht në vitet 2008 dhe 2012.

20.3.2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni administroi shkresat e noterëve³⁴, nëpërmjet të cilave u përcollën kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2008 dhe kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2012, me huadhënës shtetasin S. Gj. dhe huamarrës A. Z., përkatësisht për shumat 16.000 dollarë amerikanë dhe 34.500 dollarë amerikanë. Sipas kontratës së huas të vitit 2008, huadhënësi S. Gj. i jep huamarrësit A. Z. hua shumë prej 16.000 dollarësh amerikanë, në prani të noterës. Shuma hua është dhënë për një afat prej dy muajsh e katër ditësh. Data e dhënies së huas është data e nënshkrimit të kontratës, dhe data e përfundimit më 30.01.2009. Sipas përcaktimeve në kontratë, kthimi i shumës së marrë hua do të bëhet me një deklaratë noteriale ose me faturë bankare në afatin e përcaktuar, por mund të bëhet edhe para këtij afati. Interesi për periudhën e huas do të jetë i barabartë me 1.000 dollarë amerikanë. Pra, në përfundim të kontratës, huamarrësi është i detyruar t'i kthejë huadhënësit shumën e marrë hua dhe interesin e përcaktuar. Ndërsa, sipas kontratës së huas të vitit 2012, huadhënësi S. Gj. i jep huan prej 34.500 USD, brenda zyrës noteriale, huamarrësit A. Z., i cili deklaron se kjo shumë i duhet për të blerë automate kompjuterike. Shlyerja e kësaj huaje është parashikuar të jetë 3 muaj, duke filluar nga data 24.04.2012 deri më 24.07.2012, pa interes.

20.3.3. Huatë e sipërcituara nuk rezultojnë të jenë dekluar nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur në deklaratat e interesave privatë të viteve 2008 dhe 2012 respektivisht, apo në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit sqaroi se janë hua të marra në një kohë të shkurtër dhe të kthyera brenda vitit, pa asnjë ndikim në analizën

³⁴ Shkresë e noterës E. H., regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 18.11.2019, me të cilën përcillet kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2008. Shkresë e noterit D. H., regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 08.11.2019, me të cilën përcillet kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2012.

financiare apo dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Huatë, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi nuk përbënin burim për ndonjë nga pasuritë e subjektit të rivlerësimit. Këto hua nuk mund të jenë objekt i procesit të rivlerësimit, për sa kohë janë kthyer brenda vitit dhe nuk kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë e subjektit të rivlerësimit, apo të kenë qenë ekzistente në momentin e plotësimit të deklaratës.

20.3.4. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit depozitoi deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2019, të mbajtur nga z. A. Z. dhe z. S. Gj. Në këtë deklaratë, palët deklarojnë se kanë marrëdhënie miqësie dhe kanë munduar të krijojnë biznes së bashku, në fushën e lojërave të fatit. Për shkak se investimi i parashikuar në aktivitet nuk u arrit, huamarrësi A. Z. deklaron se shumat iu kthyen huadhënësit brenda vitit, më datë 07.12.2008 për huan e datës 26.11.2008, dhe brenda 2 muajve për huan e marrë më 24.04.2012. Për shkak të miqësisë, kthimi i huave nuk është bërë me deklaratë noteriale.

20.3.5. Sa i përket burimit të krijimit të shumave të dhëna hua, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se për shumën 16.000 USD në vitin 2008, kanë shërbyer të ardhurat e babait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit H. M., ndërsa shuma prej 34.500 USD është siguruar nga shtetasi K. M., mik i bashkëshortit të subjektit, i cili do të përfshihej si ortak në aktivitetin që do të krijohej.

20.3.6. Për të provuar këtë fakt, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: i) deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2019, të mbajtur nga H. M. dhe S. Gj. . Në këtë deklaratë, H. M. deklaron se, në vitin 2008, i ka dhënë hua bashkëshortit të vajzës, shtetasit S. Gj. , shumën 1.500.000 lekë. Kjo shumë është kthyer brenda vitit, pa kujtuar datën e saktë, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Për shkak të marrëdhënieve familjare të posaçme, nuk është bërë kontratë huaje formale, as kur është dhënë e as kur është kthyer shuma. Të njëjtin deklaram bën edhe bashkëshorti i subjektit, S. Gj. ; ii) deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2019, të mbajtur nga K. M. dhe S. Gj. . Deklaruesi K. M. deklaron t'i ketë dhënë z. Gj. shumën 34.500 USD, në funksion të hapjes së një aktiviteti në fushën e lojërave të fatit. Në kushtet kur nuk u dakordësua për çmimin e blerjes së automatëve kompjuterikë, vështirësitë në marrjen e licencës, si dhe depozitimi si garanci e një shume të papërbalueshme në raport me fitimet që do të ndaheshin, nuk u arrit të finalizohet ortakëria. Shuma e dhënë hua, deklarohet të jetë kthyer pas rreth dy muajve. Si për dhënien e huas dhe për kthimin e saj, deklarohet se nuk është përpiluar kontratë huaje apo mandat, thjesht për shkak të marrëdhënieve të besimit dhe miqësisë së hershme. Të njëjtat janë deklaruar edhe nga shtetasit A. Z. e S. Gj. në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.11.2019.

20.3.7. Për shkak të shumave të dhëna hua nga z. H. M. dhe z. K. M., duke i konsideruar këta shtetas persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision, dokumentacion mbi mundësinë financiare të z. H. M. dhe të z. K. M., për dhënien e shumave hua.

20.3.8. Referuar pretendimit të Komisionerit Publik se nuk provohet me dokumentacion justifikues të kohës dhënia e huas nga z. H. Gj. dhe z. K. M. te z. S. Gj., që më pas ky t'i huazonte te shtetasi A. Z. me kontrata të formalizuara, as kthimi i tyre dhe, në kushtet kur nuk mund të provohen me vërtetësi faktet e pretenduara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues

mban në konsideratë faktin që këto kontrata kanë të parashikuara një afat të shkurtër për shlyerjen e huas, konkretisht dy muaj e katër ditë për huan e vitit 2008 dhe 3 muaj për huan e vitit 2012, faktin që z. H. M. dhe z. K. M., referuar dokumentacionit të depozituar, justifikojnë financiarisht huatë e pretenduara të dhëna z. S. Gj. respektivisht, si dhe duke qenë se këto hua nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur, për rrjedhojë nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuadër të këtij procesi.

21. Në mbështetje të sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm.
22. Kolegji, në përfundim, e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka dhe, për pasojë, ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- 1) Lënien në fuqi të vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.
- 2) Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 14.06.2022.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtari Sokol Çomo, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, por në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vendimmarrjen time e kam bazuar vetëm në fakte juridike të natyrës procedurale dhe zbatimin e legjislacionit procedural mbi këto fakte, duke mos marrë në shqyrtim faktet juridike të natyrës materiale mbi të cilat ishte ngritur fillimisht ankimi i Komisionerit Publik, si dhe zbatimin e legjislacionit material mbi to, sikundër ka vepruar shumica e trupit gjykues.
2. Vendimi objekt shqyrtimi iu nënshtrua kontrollit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) mbi bazën e ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik Dariel Sina, në të cilin ishin parashtruar shkaqet dhe arsyet mbi bazën e të cilave kundërshtohet ky vendim, si dhe kërkimi për ndryshimin e vendimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.
3. Në përputhje me nenin F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të sipërcituar, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të Komisioneres Publike Irena Nino, subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka dhe avokates së saj Romina Zano, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit.

Pas përfundimit të hetimit gjyqësor, në fazën e bisedimeve përfundimtare të palëve, Komisionerja Publike Irena Nino u shpreh para trupit gjykues: *Në përfundim, Komisioneri Publik, në kushtet kur hetimi është shterues dhe i gjithanshëm, bazuar edhe në provat e reja të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit pranë Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin në nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë dhe në përfundim, bazuar në nenin F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i kërkojmë këtij Kolegji lënien në fuqi të vendimit nr. 241/2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.*

4. Bazuar në këto fakte juridike të natyrës procedurale, konstatoj se ankuesi, gjatë gjykimit të çështjes, ndryshoi kërkimin e parashtruar fillimisht në ankim, duke kërkuar përfundimisht nga Kolegji që vendimi i kundërshtuar nëpërmjet ankimit, të lihej në fuqi. Në vlerësimin tim, në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016, Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik, disponon në mënyrë të plotë dhe të pavarur të drejtën e ushtrimit të ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Si pasojë e kësaj të drejte ligjore, Institucioni i Komisionerëve Publikë gëzon në mënyrë ekskluzive edhe të drejtën e disponimit mbi ankimin e ushtruar prej tij, nëpërmjet institutit të “heqjes dorë nga ankimi”, në çdo fazë të gjykimit të çështjes në Kolegji.

Në çështjen objekt shqyrtimi, referuar sa më sipër, vlerësoj se, nëpërmjet kërkesës për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt ankimi, Komisionerja Publike ka pranuar në mënyrë të qartë se shkaqet mbi të cilat është ushtruar ankimi, pas shqyrtimit të tyre nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, u vlerësuan prej saj se nuk mund ta cenojnë tanimë vendimin e

kundërshtuar nëpërmjet ankimit. Një kërkim i tillë i Komisioneres Publike, pavarësisht formës së paraqitjes dhe terminologjisë së përdorur në seancën gjyqësore publike, në gjykimin tim përbën në thelb veprimin procedural të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për institutin procedural të “heqjes dorë nga ankimi”, të përcaktuar shprehimisht në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile. Bazuar në këtë institut procedural, vlerësova se, pas kërimit përfundimtar të Komisioneres Publike, Kolegji nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt ankimi dhe, për rrjedhojë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, çmova të mos marr në analizë shkaqet e ngritura fillimisht në ankim.

5. Në këto kushte, vlerësova se pasoja e vetme ligjore për situatën faktike procedurale, si më sipër analizuar, duhet të ishte lënia në fuqi e vendimit objekt ankimi, me nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

Unë, gjyqtarja Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes me vendimin nr. 20 (JR), datë 14.06.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues për arsyen si më poshtë.

1. Bazuar në nenin C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dy komisionerët publikë përfaqësojnë interesin publik në realizimin e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit, për të garantuar qëllimet e këtij procesi, të parashikuara në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës, konkretisht, funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te drejtësia. Në interpretim të këtij parashikimi kushtetues, interesi publik në këtë proces përfaqësohet nga të dy komisionerët publikë, të cilët kanë detyrimin që të ushtrojnë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar, në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim. Në përfundim të këtij kontrolli të kryer, komisionerët publikë, bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), mund të vendosin paraqitjen e një ankimi ndaj vendimit përkatës të Komisionit, ose mosankimin e tij. Ankimi i paraqitur nga komisionerët publikë ndaj vendimit të Komisionit, në përmbajtjen e tij pasqyron shkaqet në të cilat ai bazohet dhe kërkimin përfundimtar lidhur me çështjen konkrete.
2. Në ankim, Komisioneri Publik kishte kërkuar që, pasi shkaqet e ankimit [tërësisht të lidhura me kontrollin e kriterit të pasurisë] të merren në shqyrtim nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, ky i fundit të vendoste ndryshimin e vendimit nr. 241, datë 26.02.2020, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka. Në ankim, Komisioneri Publik e kishte konsideruar hetimin të plotë lidhur me faktet e shqyrtuara dhe të vlerësuara në Komision, duke mos paraqitur për këtë arsye kërkim për hetim të mëtejshëm nga Kolegji lidhur me to, por kërkoi një vlerësim të ndryshëm të situatës faktike, mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, bazuar në të cilën subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, duhej të shkarkohej. Pavarësisht mungesës së një kërkimi konkret në ankim nga Komisioneri Publik për hetime të mëtejshme nga Kolegji, gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në seancën gjyqësore publike të datës 26.05.2022, subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, në funksion të konstatimit të drejtë të situatës faktike për çështjet e trajtuara në shkaqet e ankimit, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe pranimin në cilësinë e provës të akteve të reja që u ishin bashkëngjitur parashtimeve të paraqitura paraprakisht prej saj në Kolegji. Trupi gjykues i Kolegjit, kryesisht, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të marrë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura prej saj.
3. Në bisedimet përfundimtare, në seancën gjyqësore publike të datës 31.05.2022, Komisionerja Publike u shpreh se, në kushtet kur hetimi ishte shterues dhe i gjithanshëm, bazuar edhe në provat e reja të administruara në Kolegji, subjekti i rivlerësimit arrin në nivel të besueshëm

lidhur me kriterin e pasurisë dhe në përfundim, bazuar në nenin F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 241/2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Gjoka.

4. Në vlerësimin tim, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, ndryshimi tërësisht i kërkimit të Komisioneres Publike, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, passillte mosshqyrtimin dhe moskryerjen e një vlerësimi nga Kolegji të fakteve juridike të natyrës materiale dhe mënyrës së zbatimit të ligjit material lidhur me to. Ky qëndrim është i mbështetur në argumentin se Komisionerja Publike, edhe pse në rastin konkret nuk kishte paraqitur para Kolegjit kërkesë për hetim dhe, në përfundim të tij një kërkim alternativ [ndryshim ose lënie në fuqi të vendimit të Komisionit pas kryerjes së veprimeve hetimore të caktuara], duke qenë se e konsideronte si të hetuar në mënyrë të plotë situatën faktike në Komision, në bisedimet përfundimtare ka **ndryshuar kërkimin e ankimit**. Ndryshimi i kërkimit të ankimit, në rrethanat specifike të sjelljes procedurale të Komisioneres, të sipërcituara, e vendos Kolegjin në kushtet e pranimit të tij, pa ia nënshtruar vendimin objekt shqyrtimi një vlerësimi dhe, më tej, konkludimi për situatën faktike dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me të.
5. Çmoj të theksoj se, pavarësisht sa më sipër, kërkimi i Komisioneres Publike në bisedimet përfundimtare nuk mund të konsiderohet heqje dorë nga ankimi, duke qenë se:
 - a) ky akt procedural, bazuar në parashikimet e sipërcituara kushtetuese, në këndvështrimin formal duhet të paraqitet i nënshkruar nga të dy komisionerët publikë³⁵;
 - b) duhet të referojë në bazën ligjore dhe përmbajtjen e tij në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile, për heqjen dorë nga ankimi³⁶;
 - c) në një shqyrtim të kujdesshëm të gjithë përmbajtjes së aktit procedural “Bisedime përfundimtare”, rezulton se Komisionerja, bazuar në hetimin e realizuar dhe provat e reja të administruara në Kolegj, tashmë kishte krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit kishte arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe kërkonte që, **bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, vendimi i Komisionit të lihej në fuqi**, pra nuk rezulton se ka vlerësuar dhe ka shprehur vullnet për heqje dorë nga ankimi.

Në përfundim, bazuar në sa më sipër, vlerësoj se, në këto rrethana specifike, sa i përket përmbajtjes dhe kërkimit të ankimit, si dhe kërkimit përfundimtar të Komisioneres Publike për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, me të cilin është vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Gjoka, Kolegji duhej të dispononte pa vlerësuar situatën faktike të çështjes dhe zbatimit të ligjit lidhur me të, me lënien në fuqi të këtij vendimi objekt shqyrtimi.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

³⁵ Të cilat kanë gjetur shprehjen e tyre edhe në nenin 17/1 të rregullores “Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë”:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/11/1.Rregullorja-%E2%80%99CP%C3%ABr-Veprimtarin%C3%AB-e-Institucionit-t%C3%AB-Komisioner%C3%ABve-Publik%C3%AB%E2%80%99D.pdf>

³⁶ Në këtë mënyrë është vepruar në rastin kur komisionerët publikë kanë hequr dorë nga ankimi për subjektin e rivlerësimit S. T.:

<http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/06/Heqje-dor%C3%AB-nga-ankimi-ndaj-vendimit-nr.-04-dat%C3%AB-23.03.2018.pdf>